

INSTITUI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT

LËNDA: Edukim fizik dhe sporte

Klasa: 6,7,8 dhe 9

VITI AKADEMIK 2014-2015

GRUPI I PUNËS

Prof. As. Dr. Rauf Dimraj

Prof. Dr.Fatmir Dibra

Prof. Dr.Lumturi Markola

Prof.As.Dr.Agron Cuka

Prof. Dr. Adriatik Meta

Polikseni Gorishi

Dr. Alketa Çausi

Msc. Elvira Baze

Msc. Violeta Shqevi

HYRJE

Qendra Kërkimore Shkencore e Sportit në Shqipëri, ka konstatuar se popullsia jonë aktivizohet fizikisht-atletikisht, në masën prej 4 %, domethënë aktiviteti fizik është paksuar në përmasa të theksuara dhe individit ynë është bërë sedentar. Aktualisht gjendja fizike-atletike e nxënësve nëpër shkollat e vendit tonë, paraqitet në nivele shumë të ulëta. Kjo situatë është shkaktuar nga pasiviteti fiziko-lëvizor, sedentariteti. Hipokrati, mjek i Greqisë Antike (460 - 377 para Krishtit), i cili është konsideruar babai i mjeksisë, shpjegoi se obeziteti e vendos shëndetin në rrezik dhe se ai ishte shkaku i sëmundjeve vdekjeprurëse.

Faktikisht ky pasivitet fiziko-sportiv ka cënuar gjerësisht situatën shëndetësore të qytetarëve tanë dhe ka sjellë një sërë patologjisë sic është dhjamosja, në të gjithë grupmoshat, infarkt, dhimbjet e shtyllës kurrizore, diabeti, kanceri, etj. Nuk ka ndodhur ndonjëherë në historinë e shoqërisë sonë, që popullata të goditet nga një numër kaq i shumtë viktimash të shkaktuara nga infarkti, hemoragjia cerebrale, diabeti, kanceri në mushkëri, në gji, në prostatat dhe në zorrën e trashë. Për të përmirësuar situatën e mësipërme, nevojitet të kthehet rrotullimi i rrotës, në mënyrë që të rilindë zhvillimi masiv i lëvizjes fiziko-sportive. Studjuesit dhe shkencëtarët e kësaj fushe, kanë konkluduar: “Lëvizja është themeli biologjik i shëndetit dhe aktiviteti fizik deri në plakjen e vonshme të njeriut, dhe është mrekullues e i domosdoshëm për mirëqenien e tij dhe jetën e shëndetshme, të gjatë e me standarde të larta cilësore”.

Prej shumë kohësh, lëvizja fizike e njeriut, ka qenë një aspekt i shkencave të aplikuara dhe është konsideruar faktor shumë i vlefshëm i shkencave mjekësore, biokimike, fiziologjike, anatomike, biomekanike, psikologjike, pedagogjike, sociologjike, mënyrës së të ushqyerit, etj.

Të gjithë njerëzit kërkojnë një cilësi më të mirë jete dhe prandaj duhet të zhvillojnë e gëzojnë të drejtën e aktivizimit fiziko-sportiv. Shkolla është institucioni parësorë që mund e duhet të bëjë edukimin fizik e sportiv të fëmijëve, si brezi që në vitet e ardhshme do të përfaqësojë dhe drejtojë shoqërinë.

Të aktivizohesh fizikisht-atletikisht që në moshën e kopshtit, do të thotë t’i krijosh vetes mundësinë e përfitimit të një bagazhi të gjerë eksperiencash lëvizore, dhe individit ndërjegjsohet për tu angazhuar vazhdimisht me praktikën fiziko-sportive, e në këtë mënyrë ai do gëzojë një jetë cilësore, me shëndet të plotë e pa praninë e sëmundjeve. Një fëmijë që praktikon aktivitet fiziko-sportiv, zhvillon sistemin e tij organik dhe atë lëvizor, përvetëson aftësi kordinative: të ekuilibrit, të orientimit në hapësirë e kohë, të reagimit, të kombinimit, të ritmizimit, të diferencimit, të fantazisë lëvizore dhe të parashikimit.

Aktiviteti fiziko-sportiv është një faktor i ndryshimeve të vlefshme biologjike, psikologjike dhe i rritjes sociale. Ai përmbys sëmundjet dhe depresionin e shoqërisë.

KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Shëndeti është pasuria më e çmueshme e njeriut dhe faktori parësor që mundëson nxitjen, mbështetjen, zhvillimin e idealeve dhe parimeve për progres ekonomik, social, kulturor e gjithashtu mundëson të krijohen kondita të mirëqenies dhe të arritjes së rezultateve cilësore sportive të qytetarëve tanë.

Konkluzionet e Studimeve të Mjeksisë, të Fiziologjisë së Ushtrimit fiziko-sportiv, të Sociologjisë Sportive përcaktojnë se:

- Shëndeti i qytetarëve ruhet dhe përmirsohet nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit masiv të Edukimit Fiziko-Sportiv në shkollë. Aktiviteti fiziko-sportiv që zhvillohet në mënyrë të përshtatshme dhe gjatë gjithë jetës, është një mjet i dobishëm që ndikon pozitivisht në cilësinë e jetës dhe mbron njeriun nga një sërë patologjishë.
- Për të pasur një shëndet të shkëlqyer, është e nevojshme që individi të praktikojë aktivitet fiziko-lëvizor, që synon të zhvillojë:
 1. Rezistencën, fuqinë aerobike (fuqizon sistemin organik, kardio-respirator-vaskolar).
 2. Paksimin e përqindjen dhjamore të trupit.
 3. Forcën muskulore trupore, sidomos atë të muskujve abdominalë në drejtim të rezistencës.
 4. Fleksibilitetin muskular të trupit dhe të gjymtyrëve.

Përmirsimi i gjendjes shëndetësore në vendin tonë, mundësohet nëpërmjet kontributit të vyer të mësuesit të edukimit fizik, si faktori shtetëror tepër i vlefshëm e i përgjegjshëm, që do organizojë dhe zhvillojë orën e mësimit të edukimit fizik në shkollë, sipas programit në vazhdim. Objektivat kryesore të lëndës së Edukimit fizik dhe rrjedhimisht të programit të punës së çdo mësuesi të edukimit fizik, në çdo orë me nxënësit e tij, përveç objektivave specifike për çdo temë, do të jenë:

1. **Zhvillimi i fleksibilitetit dinamik**
2. **Zhvillimi i forcës muskulore**
3. **Zhvillimi i aftësisë së reagimit**
4. **Zhvillimi i shpejtësisë**
5. **Zhvillimi i forces shpërthyesë**
6. **Zhvillimi i aftësive koordiantive**
7. **Zhvillimi i shkathtësisë**

Për të realizuar objektivat e mësipërm, në çdo orë mësimore do të kryhet kompleksi ushtrimor i mëposhtëm:

1. Vrapim i lehtë
2. Ushtrime të nxemjes së përgjithshme

3. Ushtrime të fleksibilitetit dinamik

- Vrapim me rrotulim të krahëve përpara
- Vrapim me rrotullim të krahëve mbrapa
- Vrapim me rrotullim të një pas njëshëm të krahëve përpara
- Vrapim me rrotullim të një pas njëshëm të krahëve mbrapa
- Vrapim anësor me hapa të kryqëzuar para dhe mbrapa.
- Kërcime me avancim përpara, shoqëruar me ngritjen e gjurit anash
- Kërcime me avancim përpara, shoqëruar me ngritjen e gjurit përpara (në gjoks)
- Vrapim me hapa të vegjël (mbjellës)
- Vrapim me gjunjët lartë (në gjoks)
- Vrapim me hedhje të këmbëve mbrapa (thembrat mbrapa)
- Kërcime me avancim përpara (ecje) me hedhje të këmbës para të shtrirë
- Kërcime me avancim përpara (ecje) me hedhje rrotulluese të këmbës, para-anash
- Kërcime me avancim përpara (ecje) me hedhje rrotulluese të këmbës, ansh- para
- Vrapim me hedhje rrotulluese të këmbës para-anash
- Vrapim me hedhje rrotulluese të këmbës anash-para
- Kërcime në lartësi me avancim përpara me hedhje të këmbës para të mbledhur, shoqëruar me lëvizje të ndryshme të krahëve
- Kërcim anësor me hedhje (rrotullim) të këmbës anash-para (majtas dhe djathtas)
- Imitimi i kalimit të pengesave me ngritjen e këmbës nga anash (në ecje dhe në vrapim)
- Kërcime me avancim përpara me rrotullim të baçinit.
- Kërcime me zhvendosje përpara (ecje) me hedhje rrotulluese të këmbës anash-para (në brendësi)
- Kërcime anësore majtas djathtas

4. Ushtrime të stretchingut për gjymtyrët e poshtëm (këmbët)

5. Përshpejtime 2 x 10-20m

6. Ushtrime për zhvillimin e shpejtësisë (“rapidita”-s)

- Vrapim në vend me hapa të vegjël “mbjellës”
- Vrapim në vend me spostim majtas-djathtas

- Vrapim në vend me hedhjen e këmbëve mbrapa (thembrat mbrapa)
- 7. Ushtrime për zhvillimin e forcës shpërthyesë
 - Kërcime së gjati nga vendi
- 8. Ushtrime për zhvillimin e forcë-rezistencës
 - Vrapim shumëhapësh
- 9. Ushtrime për zhvillimin e shkathtësisë
- 10. Slalom midis piketave
 - Slalom midis piketave
 - Slalom shoqëruar me rrotullim tek piketa
- 11. Ushtrime për zhvilimin e forcës muskulore
 - Për gjymtyrët e sipërm (krahët),
 - Për muskujt abdominal (të barkut),

Ushtrimet për zhvillimin e forcës mund të bëhen duke alternuar mjete të ndryshme: llastiqe, topa medicibolli, gira dhe mjete të tjera, si dhe ushtrime të zgjedhura vetëm me peshën e trupit.

PËRKULJE (SQUAT) ME TOP

Muskujt e përfshirë: muskulatura e pasme e kofshës (hamstrings) dhe gluteale (vithet).

Pozicioni i nisjes: drejtqëndrim me këmbë lehtësisht të hapura (në gjerësi të shpatullave) mbajtja e topit me dy duart e mbledhura përpara.

Ekzekutimi: duke mbajtur trupin drejt dhe shikimin përpara, thyerje e lehtë e gjunjëve. Një pauzë në këtë pozicion më pas kthehemi në pozicionin e nisjes.

Shënim: disa të rinj mund të mos jenë të aftë të kryejnë një përkulje të plotë. Në këtë rast është e nevojshme që ata të kryejnë një përkulje të pjesshme, e kufizuar në thellësinë e përkuljes dhe të vazhdohet me këtë modalitet derisa të jenë të aftë të kryejnë përkuljen e plotë të kërkuar.

ZGJATJE (PALOSJE) ME TOP

Muskujt e përfshirë: muskulatura e pasme e kofshës dhe gluteale(vithet).

Pozicioni i nisjes: drejtqëndrim me këmbë e hapura lehtësisht, mbajtja e topit me dy duart e mbledhura përpara.

Ekzekutimi: duke mbajtur trupin drejt, zhvendosje përpara me këmbën e majtë dhe realizimi i një gjysmë shalë përkulje (këmbe e thyer në gju në 90°). Një pauzë në këtë pozicion e më pas kthehemi në pozicionin e nisjes. Të përsëritet ushtrimi në mënyrë të ngjashme me këmbën e djathtë.

Shënim: përkulja e gjunjëve nuk duhet të kalojë majën e këmbës. Për të rritur intensitetin e ushtrimit, të lëvizet topi në të majtë dhe të djathtë.

SHTYTJE E TOPIT

Muskujt e përfshirë: muskujt e kraharorit, deltoid anësor dhe tricepsi.

Pozicioni i nisjes: drejtqëndrim me këmbë lehtësisht të hapura, mbajtja e topit me krahët e mbledhura përpara.

Ekzekutimi: topi shtyhet me forcë në tokë dhe në kthim lart topi kapet me dy duar si në pozicionin fillestar.

Shënim: ushtrimi mund të realizohet në çift, duke ja pasuar shokut që qëndron përpara i cili e kap topin në kërcim e sipër.

PËRPLASJE E TOPIT

Muskujt e përfshirë: muskujt e mëdhenj të shpinës, anësor dhe bicepsi.

Pozicioni i nisjes: drejtqëndrim me këmbë lehtësisht të hapura, mbahet topi lart me krahët e shtrira.

Ekzekutimi: topi përplasë me forcë në tokë me dy duar. Topi kapet me dy duar lartësinë e tij maksimale dhe kthehemi në pozicionin fillestar.

SHTRIRJE E TRICEPSIT ME TOP

Pozicioni i nisjes: drejtqëndrim me këmbë lehtësisht të hapura, topi mbahet me dy duart prapa kokës, me krahët e thyer.

Ekzekutimi: zgjaten krahët lart, pauzë dhe kthehemi në pozicionin fillestar.

NGRITJE E BUSTIT ME TOP

Muskujt e përfshirë: muskujt abdominal

Pozicioni i nisjes: shtrirë në shpinë, këmbët lehtësisht të hapura dhe të mbledhura me shputat shtrirë në tokë dhe topi mbahet me dy duart e shtrirë përpara në lartësinë e gjunjëve.

Ekzekutimi: si pozicioni fillestar (i shtrirë në shpinë), ngremë bustin përpara. Pauzë, pasi muskujt abdominalë të jenë kontraktuar plotësisht, ulim bustin duke u kthyer në pozicionin fillestar.

RROTULLIM ME TOP

Muskujt e përfshirë: muskujt abdominal rrethorë, (obliques externus).

Pozicioni i nisjes: në çift, kthyer me kurriz me njëri-tjetrin në gjysmë metër distancë largësi, këmbët lehtësisht të hapura, njëri nga shokët i mban krahët e përkulura përpara dhe me duar mban topin.

Ekzekutimi: rrotullohet busti majtas, pasohet topi dhe më pas rrotullohet busti djathtas për të marrë topin nga shoku. Topi mbahet në lartësinë e ijeve. Kryhet një numër i caktuar përsëritjesh e më pas ushtrimi ekzekutohet në mënyrë të ngjashme në krahun tjetër.

PASIM I TOPIT NGA LART DHE MIDIS KËMBËVE

Muskujt e përfshirë: deltoidi, muskujt e shpinës, erector spinae, kuadricepsi, gluteus dhe muskulatura e prapme e kofshës.

Pozicioni i nisjes: në çift, trupi drejt, vendosur me shpinë më njëri-tjetrin në një distancë gjysmë metër, këmbët lehtësisht të hapura e gjysmë të përkulura, njëri nga shokët me krahët gjysmë të mbledhura, mban topin me duar.

Ekzekutimi: zgjaten krahët lart, në linjë të drejtë me bustin, pasohet topi sipër kokës e më pas përkulet busti për të marrë topin nga shoku, midis këmbëve nga poshtë. Përfundohet një numër i caktuar përsëritjesh e më pas zhvillohet ushtrimi në krahë të kundërt.

PËRKULJE (SQUAT) ME LLASTIK

Muskujt e përfshirë: kuadricepsi, muskulatura e pasme e kofshës (hamstrings), glutealet (vithet).

Pozicioni i nisjes: drejtqëndrim me këmbët lehtësisht të hapura, në gjerësi të shpatullave, shputat e vendosura në mesin e llastikut, krahët e mbledhura mbi shpatulla dhe duart që mbërthejnë llastikun.

Ekzekutimi: duke mbajtur bustin drejt, përkulen gjunjët derisa kofshët të jenë paralele me tokën. Ndalojmë, drejtojmë këmbët dhe kthehemi në pozicionin fillestar.

Shënim: disa të rinj mund të mos jenë të aftë të kryejnë një përkulje (squat) të plotë. Me këta të rinj duhet të zhvillojmë një përkulje të kufizuar dhe të risim intensitetin gradualisht, derisa të aftësohen për të ekzekutuar ushtrimin plotësisht.

SHTYTJE ME LLASTIK NGA KRAHARORI.

Muskujt e përfshirë: muskujt e mëdhenj të kraharorit, deltoidi i përparshëm dhe tricepsi.

Pozicioni i nisjes: drejtqëndrim, këmbët lehtësisht të hapura, në gjerësi të shpatullave, krahët e mbledhura përpara që mbërthejnë llastikun.

Ekzekutimi: shtyhen krahët përpara plotësisht, pauzë, më pas kthehemi në pozicionin fillestar.

Shënim: mund të lind e nevojshme të shkurtohet gjatësia e llastikut për të caktuar një rezistencë të përshtatshme.

RREMTAR ULUR ME LLASTIK

Muskujt e përfshirë: muskujt e mëdhenj të shpinës, bicepsi.

Pozicioni i nisjes: ndenjtur me këmbët e bashkuara dhe të shtrira përpara, duart që mbërthejnë llastikun që tërhiqet nga brënda (llastikun reth këmbëve). Gjunjët lehtësisht të përkulura.

Ekzekutimi: duke mbajtur bustin drejt, tërhiqet llastiku duke mbledhur të dy krahët krahët prapa në kënd. Ndalohet, kthehemi në pozicionin fillestar.

SHTYTJE E KRAHËVE LART ME LLASTIK NGA QËNDRIMI ULUR

Muskujt e përfshirë: deltoid, trapezoid në pjesën e sipërme, tricepsi.

Pozicioni i nisjes: ndenjtur mbi fashën e llastikut (në mesin e të ndenjura), këmbët lehtësisht të hapura, krahët e mbledhur në shpatulla dhe duart që mbërthejnë llastikun në lartësinë e shpatullave.

Ekzekutimi: duke mbajtur bustin drejt, shtyhen krahët lart. Pauzë, mblidhen krahët dhe kthehemi në pozicionin fillestar.

TËRHEQJE ME LLASTIK NË KRAHAROR

Muskujt e përfshirë: deltoidi, trapezoid në pjesën e sipërme, bicepsi.

Pozicioni i nisjes: drejtqëndrim me këmbët e bashkuara, qëndrohet mbi fashën e llastikut e mbërthyer me shputat e këmbëve, me duart e shtrira poshtë që mbërthejnë llastikun.

Ekzekutimi: duke mbajtur bustin drejt, mbledhim krahët në lartësinë e kraharorit, duke ekzekutuar një tërheqje maksimale të llastikut, derisa bërrylat të shkojnë mbi lartësinë e shpatullave. Pauzë, më pas përkulen krahët dhe kthehemi në pozicionin fillestar.

NGRITJE E KRAHËVE JASHTË ME LLASTIK

Muskujt e përfshirë: deltoidi.

Pozicioni i nisjes: drejtqëndrim me këmbët lehtësisht të hapura, mbi fashën e llastikut në pjesën qendrore të shputave, krahët e shtrirë drejt në një linjë me bustin dhe duart që mbërthejnë llastikun.

Ekzekutimi: duke mbajtur bustin drejt, hapje e llastikut anash me dy shtrirë. Pauzë, ulen krahët dhe kthehemi në pozicionin fillestar.

Shënim: të mbahen bërrylat lehtësisht të përkulura dhe busti drejt përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së ushtrimit.

PËRKULJE E KRAHËVE ME LLASTIK

Muskujt e përfshirë: bicepsi.

Pozicioni i nisjes: drejtqëndrim me këmbët e bashkuara të vendosura në mes, mbi fashën e llastikut, krahët e shtrira poshtë që mbërthejnë llastikun me dy duar anash.

Ekzekutimi: mblidhen krahët, derisa duart të arrijnë në lartësinë e shpatullave. Pauzë, më pas ulen krahët dhe kthehemi në pozicionin fillestar.

Shënim: të ruhet pozicioni drejt i bustit përgjatë të gjithë ushtrimit.

POZICIONI I MBAJTJES SË FASHËS SË LLASTIKUT ME DORË.

Ushtrime me Gira

PËRKULJE (SQUAT) ME GIRA

Muskujt e përfshirë: muskulatura e pasme e kofshës (hamstrings) dhe glutealet.

Pozicioni i nisjes: drejtqëndrim me këmbë lehtësisht të hapura (në gjerësi të shpatullave) mbajtja e girave me duar anash, poshtë.

Ekzekutimi: duke mbajtur trupin drejt dhe shikimin përpara, thyerje e lehtë e gjunjëve.. Një pauzë në këtë pozicion, më pas kthehemi në pozicionin fillestar.

USHTRIME MBI STOL

Muskujt e përfshirë: muskujt e mëdhenj të krahavorit, (grandi pettorali) dhe tricepsi.

Pozicioni i nisjes: shtrirë në shpinë me këmbë të mbledhura mbi stol, mbajmë me krahë të mbledhura girat me dy duar në krahavor.

Ekzekutimi: Shtrirja e krahëve lart. Një pauzë në këtë pozicion më pas kthehemi në pozicionin fillestar.

USHTRIM MBI STOL

Muskujt e përfshirë: muskulatura e pasme e shpinës, (bicepsi).

Pozicioni i nisjes: Mbështetemi me njërin gju dhe me të njëjtin krah mbi stol, krahu tjetër i shtrirë mban girën dhe këmba e shtrirë në pozicion pingul me token.

Ekzekutimi: Mbledhja e krahut me girë në gjoks. Një pauzë në këtë pozicion dhe më pas kthehemi në pozicionin fillestar.

USHTRIM MBI STOL ME GIRA

Muskujt e përfshirë: deltoidi, tricepsi

Pozicioni i nisjes: Ndenjur në anë të stolit, krahët e mbledhura mbi supe që mbajnë girat.

Ekzekutimi: Ngritja e girave me dy krahët e shtrirë lart. Një pauzë në këtë pozicion dhe më pas kthehemi në pozicionin fillestar.

USHTRIM ME GIRA

Muskujt e përfshirë: bicepsi

Pozicioni i nisjes: Drejtqëndrim, me dy këmbë të hapura në gjerësinë e shpatullave, krahët e shtrira poshtë që mbajnë girat.

Ekzekutimi: Mbledhje e krahëve përpara me girat në nivelin e supeve. Një pauzë në këtë pozicion dhe më pas kthehemi në pozicionin fillestar.

USHTRIME ME GIRA

Muskujt e përfshirë: bicepsi

Pozicioni i nisjes: Drejtqëndrim, me dy këmbë të hapura në gjerësinë e shpatullave, krahët e shtrira poshtë që mbajnë girat.

Ekzekutimi: Ngritja e shpatullave lart. Një pauzë në këtë pozicion dhe më pas kthehemi në pozicionin fillestar.

USHTRIME TË FORCIMIT TË MUSKLATURËS SË TRUNGUT

Muskujt e përfshirë: muskujt rethorë abdominal

Pozicioni i nisjes: shtrirë në shpinë mbi një tapet gjimnastikor, këmbët gjysëm të mbledhura të mbështetura në shputa dhe krahët e kryqëzuara në kraharor.

Ekzekutimi: Ngritje e bustit para. Një pauzë në këtë pozicion dhe më pas kthehemi në pozicionin fillestar.

USHTRIME TË FORCIMIT TË MUSKLATURËS SË TRUNGUT

Muskujt e përfshirë: muskujt e shpinës, lombare, gluteale dhe të shpatullave

Pozicioni i nisjes: shtrirë mbi gjoks përpara me krahët e shtrira para në nivelin e kokës, këmbë të shtrira prapa.

Ekzekutimi: Ngritja e njëkohëshme e dorës dhe këmbës së kundërt. (përsëritet me të dy anësitë).

USHTRIME TË FORCIMIT TË MUSKLATURËS SË TRUNGUT

Muskujt e përfshirë: muskujt e shpinës, të shpatullave, gluteale dhe abdominale

Pozicioni i nisjes: mbështetur mbi gjunjë dhe me krahët e shtrira në e shpatullave s mbi një tapet gjimnastikor, trangu i shtrirë.

Ekzekutimi: Shtrirja e gjunjëve duke ruajtur pozicionin e shtrirë të krahëve. Një pauzë në këtë pozicion dhe më pas kthehemi në pozicionin fillestar.

USHTRIME TË FORCIMIT TË MUSKLATURËS SË TRUNGUT (NË TË DY KRAHËT)

Muskujt e përfshirë: muskujt e shpinës, të shpatullave, gluteale dhe abdominale

Pozicioni i nisjes: shtrirë në pozicionin anësor brinjor (ijës) mbështetur mbi një parakrah, dora tjetër e mbështetur përpara, këmbët të shtrira dhe shikimi para drejt.

Ekzekutimi: Ngritja e gollganëve lart duke ruajtur pozicionin fillestar të krahëve dhe të këmbëve. Një pauzë në këtë pozicion dhe më pas kthehemi në pozicionin fillestar.

USHTRIME TË FORCIMIT TË MUSKLATURËS SË TRUNGUT

Muskujt e përfshirë: muskujt e shpinës, të shpatullave, gluteale dhe abdominale

Pozicioni i nisjes: ndenjtur me këmbë të shtrira para, të mbështetur me bërryla në tokë, shikimi para.

Ekzekutimi: Ngritja e kraharorit para duke ruajtur pozicionin fillestar të krahëve dhe të këmbëve. Një pauzë në këtë pozicion dhe më pas kthehem në pozicionin fillestar.

USHTRIME TË FORCIMIT TË MUSKLATURËS SË TRUNGUT

Muskujt e përfshirë: muskujt e shpinës, të shpatullave, gluteale dhe abdominale

Pozicioni i nisjes: shtrirë në pozicionin anësor brinjor (ijës) mbështetur mbi një parakrah, dora tjetër e mbështetur përpara, këmbët të shtrira dhe shikimi para drejt.

Ekzekutimi: Ngritja e gollganëve lart duke ruajtur pozicionin fillestar të krahëve dhe të këmbëve. Një pauzë në këtë pozicion dhe më pas kthehem në pozicionin fillestar.

Programi përmban numrin e orëve për cdo linjë, të cilat tregojnë orët e sugjeruara. Kjo i mundëson mësuesit që të bëjë në mënyrë të lirë, një riorganizim në masën 20% prej numrit të orëve të sugjeruara, duke i zhvendosur si shtim apo si pakësim nëpër linja dhe kështu realizon përshtatshmëri me kushtet që ofron shkolla, referuar infrastrukturës së saj, vendosjes gjeografike nga pikëpamja e kushteve klimaterike, si dhe traditës sportive të shkollës (apo qytetit).

Në trajtimin e 105 orëve në plan tematik, afërsisht 30% e orëve mësimore të secilës linjë, do të rezervohet temave që trajtojnë njohuri të reja të kësaj lënde, ndërsa 70% e tyre (pjesa mbetur e orëve), do të përdoren për përsëritjen dhe përpunimin e njohurive. Në ndarjen e orëve mësimore në planin tematik do parashikohen gjithashtu edhe orët për testimet (vlerësimin në kolonë) sipas linjave, si dhe për vlerësimin e cilësive fizike-atletike, aftësive koordinative, si dhe orët për aktivitetet e ndryshme.

VLERËSIMI

Për vlerësimin e arritjeve të nxënësve do shërbejnë matjet praktike që do pasqyrohen në “Kartela individuale e nxënësit”, të cilat realizohen nëpërmjet mjeteve, instrumentave, pajisjeve të thjeshta. Gjithashtu vetë mësuesi i edukimit fizik, nëpërmjet vëzhgimit, bashkëbisedimit, filmimeve të mundëshme, bën vlerësime të ekzekutimit teknik nga pikëpamja e biomekanikës lëvizore, për cdo nxënës.

**PËRMBAJTJA E PROGRAMIT DHE
ORËT E SYGJERUARA
PËR LINJA DHE NËNLINJA**

KLASA E GJASHTË

3 orë në javë/ 35 javë mësimore, 105 orë vjetore

Nr.	Linja	Numri i orëve të sygjeruara
1.	Njohuri të edukimit fizik	3 orë matje antropometrike, pjesa tjetër e shtrirë në realizimin e gjithë programit.
2.	Veprime lëvizore bazë	20 orë
3.	Manipulim lëvizjesh me dhe pa mjete	10 orë
5.	Vallëzim ritmik	10 orë
6.	Lojra lëvizore	20 orë
7.	Veprimtari sportive	42 orë
	TOTALI	105 orë

Linja 1: NJOHURI TE EDUKIMIT FIZIK (gjatë procesit mësimor)

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
1 1/1	Ndërtimi i aparatit lëvizor mbështetës të trupit Eshtrat kryesore të trupit (skeletit)	<ul style="list-style-type: none"> • Eshtrat kryesore të ekstremiteteve. • Eshtrat kryesore të kolonës vertebrore. 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit të dinë vendndodhjen e eshtrave kryesore, sipas emërimit të tyre (me prekje); • Të dinë nivelin e osifikimit për moshën e tyre; • Të dinë si të mbrojnë eshtrat nga dëmtimet. 	<p>a) Niveli i përparuar Nxënësi njih shumë mirë vendndodhjen e emërimit e eshtrave kryesore të ekstremiteteve dhe kolonës vertebrore; njih shumë mirë nivelin e osifikimit për moshën që ka dhe mënyrat e mbrojtjes së eshtrave nga dëmtimet e mundshme.</p> <p>b) Niveli mesatar Nxënësi njih mirë vendndodhjen e emërimit e eshtrave kryesore të ekstremiteteve dhe kolonës vertebrore; njih nivelin e osifikimit për moshën që ka, por herë-herë shfaq paqartësi në detaje të vogla; njih disa mënyra të mbrojtjes së eshtrave nga dëmtimet e mundshme.</p> <p>c) Niveli i ulët Nxënësi nuk njih sa duhet vendndodhjen e emërimit e eshtrave kryesore të ekstremiteteve dhe të kolonës vertebrore; nuk ka të qartë nivelin e osifikimit për moshën që ka; njih disi ndonjë mënyrë të mbrojtjes së eshtrave nga dëmtimet e mundshme.</p>

<p>1 1/2</p>	<p>Ndërtimi i aparatit lëvizor mbështetës të trupit Muskujt kryesorë të trupit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Pjesët kryesore të muskulit. • Muskujt e mëdhenj të ekstremiteteve. • Muskujt e mëdhenj të gjoksit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit të dinë vendndodhjen e muskujve të mëdhenj të ekstremiteteve, sipas emërimit të tyre (me prekje); • Të dinë vendndodhjen e muskujve të mëdhenj të gjoksit, sipas emërimit të tyre (me prekje); • Të njohin mënyrat e mbrojtjes së muskujve nga dëmtimet e mundshme. 	<p>a) Nxënësi njih shumë mirë vendndodhjen e emërimit e muskujve kryesorë të ekstremiteteve dhe të gjoksit; njih shumë mirë pjesët kryesore të muskulit dhe mënyrat e mbrojtjes së muskujve nga dëmtimet e mundshme.</p> <p>b) Nxënësi njih mirë vendndodhjen e emërimit e muskujve kryesorë të ekstremiteteve dhe të gjoksit; njih pjesët kryesore të muskulit, por herë-herë shfaq paqartësi në detaje të vogla; njih disa mënyra të mbrojtjes së muskujve nga dëmtimet e mundshme.</p> <p>c) Nxënësi nuk njih sa duhet vendndodhjen e emërimit e muskujve kryesorë të ekstremiteteve dhe të gjoksit; nuk ka të qarta pjesët kryesore të muskulit; njih disi ndonjë mënyrë të mbrojtjes së muskujve nga dëmtimet e mundshme.</p>
	<p>Ndërtimi i aparatit lëvizor mbështetës të trupit Kyçet kryesore të trupit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kyçet kryesore të ekstremiteteve, që vënë në lëvizje trupin e njeriut. • Pjesët përbërëse të kyçit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit të dinë vendndodhjen e kyçeve kryesore të ekstremiteteve, sipas emërimit të tyre (me prekje); • Të dinë pjesët kryesore 	<p>a) Nxënësi njih shumë mirë vendndodhjen e emërimit e kyçeve kryesore të ekstremiteteve; njih shumë mirë pjesët kryesore përbërëse të kyçit e mënyrat e mbrojtjes së kyçeve nga dëmtimet e mundshme.</p>

1 1/3			<p>përbërëse të kyçit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dinë të mbrojnë kyçet nga dëmtimet. 	<p>b) Nxënësi njih mirë vendndodhjen e emërtimeve të kyçeve kryesore të ekstremiteteve; njih pjesët kryesore përbërëse të kyçit, por herë-herë shfaq paqartësi në detaje të vogla; njih disa mënyra të mbrojtjes së kyçeve nga dëmtimet e mundshme.</p> <p>c) Nxënësi nuk njih sa duhet vendndodhjen e emërtimeve të kyçeve kryesore të ekstremiteteve; nuk ka të qarta pjesët kryesore të kyçit; njih disi ndonjë mënyrë të mbrojtjes së kyçeve nga dëmtimet e mundshme.</p>
2	<p>Funksionet e aparatit lëvizor mbështetës</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Llojet e tkurrjeve muskulore gjatë veprimtarive lëvizore. • Parimi i llozit në lëvizjet e pjesëve të trupit në kyçe. • Llojet e lëvizjeve të pjesëve të trupit në kyçe. 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit të kuptojnë tkurrjen muskulore dhe të dinë të provojnë llojet e tkurrjeve muskulore; • Të dinë të tregojnë në praktikë llojet e lëvizjeve në kyçe; • Të dinë të tregojnë elementet përbërës të llozit. 	<p>a) Nxënësi njih shumë mirë dhe di të tregojë me saktësi në praktikë llojet e tkurrjeve muskulore; di shumë mirë të tregojë në praktikë llojet e lëvizjeve në kyçe dhe njih shumë mirë parimin e llozit në lëvizjet e pjesëve të trupit në kyçe.</p> <p>b) Nxënësi njih mirë dhe di të tregojë me pak ndihmë në praktikë llojet e tkurrjeve muskulore; di mirë të tregojë në praktikë llojet e lëvizjeve në kyçe dhe njih disi parimin e llozit në lëvizjet e pjesëve</p>

				të trupit në kyçe. c) Nxënësi njih dhe di të tregojë (por jo pa ndihmë) në praktikë llojet e tkurrjeve muskulore; di të tregojë në praktikë lloje të veçanta të lëvizjeve në kyçe dhe shfaq paqartësi për parimin e llozit në lëvizjet e pjesëve të trupit në kyçe.
3	Sjellja lëvizore e njeriut	<ul style="list-style-type: none"> • Lëvizja është jetë. • Lëvizja ndihmon plotësimin e nevojave të përditëshme. • Lëvizja ndihmon çlodhjen e argëtimit tone. • Lëvizja ndihmon rritjen e përmasave trupore dhe funksionimin normal të trupit. • Pse nuk duhet të shqetësohemi nga ndryshimet trupore dhe fiziologjike të rritjes (shenjat e dyta të pjekurisë seksuale). 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit të kuptojnë vlerat e veprimeve lëvizore për jetën e përditëshme, për çlodhjen e për argëtimin. • Të kuptojnë ndryshimet fiziologjike, që ndodhin në periudhën e pubertetit. 	<p>a) Nxënësi njih shumë mirë dhe di të tregojë me saktësi vlerat e veprimeve lëvizore për jetën e përditëshme, për çlodhjen e për argëtimin. Ai shfaq bindje të qarta për ndryshimet fiziologjike, që ndodhin në periudhën e pubertetit.</p> <p>b) Nxënësi njih dhe di të tregojë (por jo plotësisht) vlerat e veprimeve lëvizore për jetën e përditëshme, për çlodhjen e për argëtimin. Ai shfaq bindje të qarta për ndryshimet fiziologjike, që ndodhin në periudhën e pubertetit.</p> <p>c) Nxënësi nuk njih dhe nuk di të tregojë vlerat e veprimeve lëvizore për jetën e përditëshme, për çlodhjen e për argëtimin. Ai shfaq mangësi dhe nuk mund të shprehet pa ndihmën e mësuesit për ndryshimet fiziologjike, që ndodhin në periudhën e pubertetit.</p>

4	Higjiena e ushtrimeve fizike	<ul style="list-style-type: none"> • Veshja dhe vlerat e saj, gjatë të ushtruarit në vende dhe temperature të ndryshme. • Djersitja si dukuri normale e organizmit. Pasojat e saj gjatë dhe pas të ushtruarit. • Pastërtia e trupit pas të ushtruarit është nevojë për shëndet të mirë dhe bukuri fizike. • Stërmundimi (mbilodhja). Si të mbrohemi nga ai. • Vlerat e pastërtisë së ajrit, të mjeteve dhe mjedisit në vendin e të ushtruarit. • Mbrojtja nga sëmundjet e lëkurës në veprimtarinë e përbashkët lëvizore (kontakti, veshja, mjedisi. etj.) • Ushqimi dhe roli i tij në rritjen e në funksionimin e organizmit. Përbërësit ushqimorë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit të kuptojnë vlerat shëndetsore të veshjes, të pastërtisë së trupit e të mjedisit gjatë dhe pas të ushtruarit; • Të njohin rolin e ushqimit në rritjen e në funksionimin e organizmit; • Të njohin nivelet e ngarkesës fiziologjike gjatë të ushtruarit; • Të njohin shformimet fizike dhe t'i parandalojnë ato. 	<p>a) Nxënësi njih shumë mirë dhe di të tregojë me saktësi vlerat shëndetësore të veshjes, pastërtisë së trupit e të mjedisit gjatë dhe pas të ushtruarit. Ai shfaq bindje të qarta për rolin e ushqimit në rritjen e në funksionimin e organizmit. Njih shumë mirë nivelet e ngarkesës fiziologjike gjatë të ushtruarit. Gjithashtu, njih shumë mirë shformimet fizike dhe di t'i parandalojë ato.</p> <p>b) Nxënësi njih dhe di të tregojë vlerat shëndetsore të veshjes, pastërtisë së trupit e të mjedisit gjatë dhe pas të ushtruarit. Ai njih rolin e ushqimit në rritjen e në funksionimin e organizmit. Me ndihmën e mësuesit është në gjendje të interpretojë nivelin e ngarkesës fiziologjike gjatë të ushtruarit. Njih shformimet fizike, por nuk di t'i parandalojë ato.</p> <p>c) Nxënësi nuk njih dhe nuk di të tregojë vlerat shëndetësore të veshjes, pastërtisë së trupit e të mjedisit gjatë dhe pas të ushtruarit. Ai njih, por jo plotësisht, rolin e ushqimit në rritjen e në funksionimin e organizmit. Nuk ka</p>
---	------------------------------	--	---	--

				njohuri për nivelin e ngarkesës fiziologjike gjatë të ushtruarit. Njeh pjesërisht shformimet fizike dhe nuk di t'i parandalojë ato.
5	Metodika e të ushtruarit të pavarur	<ul style="list-style-type: none"> • Akti dhe reagimi lëvizor. • Veprimi lëvizor (jetësor, artificial e sportiv). • Ushtrimi fizik. • Cilësitë antropometrike. • Aftësitë fizike (lëvizore). • Mënyrat e zhvillimit të përkulshmërisë dhe të forcës muskulore. 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit të kuptojnë konceptet: akt lëvizor, veprim lëvizor e ushtrim fizik; • Të kuptojnë konceptet: cilësi antropometrik dhe aftësi fizike (lëvizore); • Të dinë rregullat kryesore të zhvillimit të përkulshmërisë dhe të forcës muskulore. 	<p>a) Nxënësi njeh shumë mirë dhe interpreton saktë konceptet: akt lëvizor, veprim lëvizor, ushtrim fizik, cilësi antropometrike dhe aftësi fizike (lëvizore). Ai di mirë rregullat kryesore të zhvillimit të përkulshmërisë dhe të forcës muskulore; njeh 2-3 ushtrime për zhvillimin e përkulshmërisë dhe 2-3 ushtrime për zhvillimin e forcës muskulore.</p> <p>b) Nxënësi njeh e me ndihmën e mësuesit (mësueses), di të interpretojë konceptet: akt lëvizor, veprim lëvizor, ushtrim fizik, cilësi antropometrike dhe aftësi fizike (lëvizore). Ai di disa rregulla kryesore të zhvillimit të përkulshmërisë dhe të forcës muskulore; njeh të paktën 1 ushtrim për zhvillimin e përkulshmërisë dhe 1 për zhvillimin e forcës muskulore.</p> <p>c) Nxënësi nuk njeh e nuk di të interpretojë konceptet: akt lëvizor, veprim lëvizor, ushtrim fizik, cilësi antropometrike dhe aftësi fizike (lëvizore). Ai nuk di rregullat</p>

				kryesore të zhvillimit të përkulshmërisë dhe të forcës muskulore; nuk njih asnjë ushtrim për zhvillimin e përkulshmërisë dhe asnjë për zhvillimin e forcës muskulore.
6	Lëvizja olimpike	<ul style="list-style-type: none"> • Fillesat e olimpiadave të lashtësisë. Si u organizuan ato? • Qëllimet e vlerat e olimpizmit klasik. • Karakteristikat organizative dhe ideore të olimpiadave moderne. • Loja e ndershme-thelbi i filozofisë olimpike. 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit të dinë si lindën e si u organizuan olimpiadat; • Të kuptojnë qëllimet kryesore dhe karakteristikat e organizimit të olimpiadave në kohën e sotme; • Të kuptojnë se ç'është loja e ndershme në sport. 	<p>a) Nxënësi di me detaje si lindën e si u organizuan olimpiadat, qëllimet kryesore dhe karakteristikat e organizimit të olimpiadave në kohën e sotme dhe në çdo veprimtari gare ose në çdo lojë, ku merr pjesë, tregohet i ndershëm e i virtutshëm.</p> <p>b) Di si lindën e si u organizuan olimpiadat, njih disa nga qëllimet dhe karakteristikat e organizimit të olimpiadave dhe në veprimtari të veçanta gare ose në disa veprimtari-lojë, ku merr pjesë.</p> <p>c) Nuk di si lindën e si u organizuan olimpiadat, nuk njih qëllimet kryesore dhe karakteristikat e organizimit të tyre, të veprimtarive garë ose lojë ku merr pjesë, shfaq shenja nervozizmi, egoizmi dhe shthurjeje të herëpashershme të sjelljes me shokët ose me kundërshtarët.</p>

2. VEPRIME LEVIZORE BAZE

Nr.	NENLINJAT	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
2.1	Me topa të mbushur 1 kg	<p>a- Mbajtja e topit me duar: poshtë, lart me krahë të përkulur dhe të shtrirë.</p> <p>b-Mbajtja e topit me një dorë (të majtën e të djathtën): para, anash, lart me krahët të shtrirë dhe të përkulur.</p> <p>c-shtytja e topit: me dy duar nga gjoksi dhe nga koka; me një dorë nga supi.</p> <p>Ç- Hedhja e topit vertikalisht me dy duar nga poshtë dhe pritja e tij.</p> <p>d- Hedhja dhe pritja e topit para dhe prapa me dy duar dhe pritja e tij nga partneri, nga një largësi që vjen duke u rritur.</p>	Nxënësit të jenë në gjendje të ekzekutojnë veprimet e mbajtjeve, të shtytjeve dhe hedhjeve të topit.	<p>a) Ekzekutojnë të gjitha veprimet e mësuara, si: mbajtjet, hedhjet e shtytjet.</p> <p>b) Ekzekutojnë 4 nga 5 veprimet lëvizore të mësuara.</p> <p>c)Ekzekutojnë 3 nga 5 veprimet lëvizore të mësuara.</p>
2.2	Me shkopinj gjimnastikorë	<p>a-Me kapjen e gjerë të shkopit në qëndrimin poshtë rrethrotullim i shpatullave para dhe prapa.</p> <p>b- Qëndrim skermë. Me kapjen në fillim, shkopi i shtrirë para –poshtë, këmba e djathtë një para (me dorën që do) e përkulur në gju. Krahu i kundërt i shtrirë prapa-poshtë. Hapa para, prapa, majtas e djathtas.</p> <p>c-Nga qëndrimi skermë: heqja e një objekti të vogël me shkop nga një rreth me diametër 40 cm (me çifte).</p>	Nxënësit të jenë në gjendje të ekzekutojnë veprimet me shkopin gjimnastikorë me shpejtësi të moderuar.	<p>a)Ekzekutojnë pa gabime veprimet me shkopinjt gjimnastikorë dhe me ritmin e kërkuar.</p> <p>b) Ekzekutojnë pa gabime veprimet me shkopinjt gjimnastikorë, por me ritëm të ngadaltë.</p> <p>c) Ekzekutojnë me pak gabime veprimet me shkopinjt gjimnastikorë dhe me ritëm të ngadaltë.</p>

		Ç-Goditje me shkop (me 1 e 2 duar) i një objekti që fluturon me shpejtësi në drejtim të nxënësit, hedhur nga partneri.		
2.3	Me gantela (500g).	a- Këmbët e hapura anash sa gjerësia e shpatullave. Krahët shtrirë poshtë. b-Krahët ngrihen me ngadalë anash dhe ulen përsëri poshtë.3 * 10. c-Si në a) e b) por krahët kalojnë nga anash në para lart. d- Rrotullime të rrethit të supit nga para dhe prapa.2*10.	Nxënësit të jenë në gjendje të ekzekutojnë veprimet me gantela për muskujt e trupit.	a) Ekzekutojnë pa gabime veprimet me gantela dhe me kohëzgjatjen e caktuar. b) Ekzekutojnë pa gabime veprimet me gantela, por me kohëzgjatje të vogël. c) Ekzekutojnë me pak gabime dhe me kohëzgjatje të vogël.
2.4	Ecjet e lira.	a- Ecje thembër –majë me hap që vjen duke u shpejtuar. b-Ecje të shpejta me hap të vogël në formë zigzag duke imituar aeroplanin dhe fluturën. c-Ecje mbi majat e këmbëve mbi sende të ndryshme të vendosura në largësi mbi 20 m. Ç - Ecje me majë të këmbëve në një vijë të drejtë në formë çiftesh e treshesh, shoqëruar me lëvizjen e krahëve para, anash, lart me nisje të njëpasnjëshme. Këto me një ritëm të caktuar që jepet me komandën e mësuesit ose me muzikë.	Nxënësit të jenë gjendje të demostrojnë ecjet e ndryshme duke bashkërenduar lëvizjet.	a) Ekzekutojnë pa gabime ecjet e mësuara të bashkërenduara këto me lëvizjet e krahëve me shpejtësi të caktuar. b) Ekzekutojnë pa gabime ecjet e mësuara, të shoqëruara këto me pak gabime në bashkërendimin e lëvizjeve. c) Ekzekutojnë me pak gabime ecjet e mësuara, të shoqëruara me pak gabime në bashkërendimin e lëvizjeve.
2.5	Vrapimet e lira.	a-Vrapim shpejtësie me çifte e treshe duke tërhequr balonën me fill. b-Vrapim i lehtë aerobik me	Nxënësit të jenë në gjendje të vrapojnë lirisht me dhe pa mjete në largësi të ndryshme me shpejtësi që rritet në mënyrë të	a) Vrapojnë lirshëm me dhe pa mjete deri në largësi 400-500 m. b) Vrapojnë lirshëm me dhe

		<p>kapërcim pengesash të ulta (20 cm) deri 500 m, shoqëruar me ecje çdo 50 m.</p> <p>c-Vrapim i lehtë me rrotullimin e rrethit në vij të drejtë dhe zigzag në largësi 200 m, pa ndërprerje.</p> <p>Ç- Vrapim i lehtë nën tingujt e muzikës me nisje të njëpasnjëshme treshe e katërshe, të shoqëruara edhe me kërcime në vend, mbas 50 m.</p>	përshkallëzuar.	<p>pa mjete deri në largësi 340 –400 m</p> <p>c) Vrapojnë lirshëm me dhe pa mjete deri në largësi 200 m.</p>
2.6	Kërcimet e lira.	<p>a-Kërcim së larti me vrull anësor e ballor në lartësi 50 cm, me menyrën e kërcimit dhe largësinë e zgjedhur nga vete nxënësit.</p> <p>b- Kërcim i lirë së gjati me vrull anësor dhe ballor me menyrën e kërcimit dhe largësinë e zgjedhur nga vetë nxënësit.</p> <p>c-Kërcim me litarin vetjak me një e dy këmbë mbi sende të ndryshme (dyshek, pod, stola etj.).</p>	Nxënësit të jenë gjendje të kërcëjnë lirshëm në forma dhe shpejtësi të ndryshme.	<p>a)Kërcejnë lirshëm në forma të ndryshme me shpejtësi që rritet në menyrë të përshkallëzuar.</p> <p>b)Kërcejnë lirshëm në forma të ndryshme, por me të njëjtën shpejtësi (nën mesatare).</p> <p>c)Kërcejnë me pak gabime, të shoqëruar me shpejtësi të ulët.</p>

2.7	Lëvizjet kundërvepruese.	<p>a-Nxënësi kap këmbët e shokut me të dyja duart, ndërsa ky i fundit ecën duke shtyrë me të dyja duart tokën për 2-4 m.</p> <p>b-Tërheqje me çifte të litarit me 1 dhe 2 duar.</p> <p>c-Si më lart, por nga qëndrimi ndenjtur me pozicion të ndryshëm të këmbëve.</p>	Nxënësit të jenë në gjendje të demonstrojnë me saktësi veprimet kundërvepruese.	<p>a)Demonstrojnë me saktësi të gjitha veprimet kundërvepruese të mësuara,në largësitë e kohëzgjatje të caktuara.</p> <p>b)Demonstrojnë pa gabime veprimet kundërvepruese në largësi e kohëzgjatje të vogël.</p> <p>c)Demonstrojnë me pak gabime veprimet kundërvepruese dhe në largësi e kohëzgjatje të vogël.</p>
2.8	Drejtëshim statik dhe dinamik.	<ul style="list-style-type: none"> • Ecje mbi mjete dhe lartësi të ndryshme: <ul style="list-style-type: none"> a-Ecje me majat e këmbëve në një vijë, litar, spango e shtrirë në tokë . b- Si në a), por në stolin gjimnastikor. c- Si në a) e b), por në traun e ekuilibrit. • Qëndrime mbi mjete me një këmbë: <ul style="list-style-type: none"> a- Kthime në vend mbi njerën këmbë 180-360 gradë në një rreth të vizatuar ne tokë me një rreze rreth 15 cm. b-Si në a), por në stolin gjimnastikor. c-Si në a) dhe b), por në traun e ekuilibrit. 	Nxënësit të jenë në gjendje të qëndrojnë dhe të ecin mbi mjete, duke mbajtur drejtëshimin në një kohe të caktuar.	<p>a)Ruajnë për disa sekonda drejtëshim statik dhe nuk e humbasin drejtëshimin dinamik.</p> <p>b)Ruajnë për pak sekonda drejtëshimin statik dhe nuk e humbasin drjetpeshimin dinamik.</p> <p>c)Ruajnë për pak sekonda drejtëshimin statik dhe gabojnë në disa raste në drejtëshimin dinamik.</p>

3. MANIPULIM LËVIZJESH ME DHE PA MJETE (20 ORE)

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
1.	Me pjatelë	<p>a. Hedhja e pjatelës nga vendi në largësi</p> <p>b. Hedhja dhe pritja e pjatelës me çifte nga vendi</p> <p>c. Hedhja e pjatelës nga vendi në lartësi dhe pritja e saj.</p>	Të demonstrojnë hedhjen e pjatelës në largësi e lartësi, duke rritur largësinë, dhe ta presin atë me të dyja duart.	<p>a)E hedhin pjatelën në largësi e lartësi 5 herë dhe arrijnë ta presin 4 herë.</p> <p>b)E hedhin pjatelën në largësi e lartësi 4 herë dhe arrijnë ta presin 2 herë</p> <p>c)E hedhin pjatelën në lartësi e largësi 2 herë dhe arrijnë ta presin 1 herë</p>
2.	Me tullumbace	<p>a. Goditjet e tullumbaces në pjesët e trupit në formë xhonglimi</p> <p>b. Mbajtja e tullumbaces në drejtpeshim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - me kokë - me sup - me gisht 	Të xhonglojnë tullumbacen me pjesët e ndryshme të trupit dhe ta mbajnë atë në drejtpeshim për një kohë të caktuar me të tria pjesët e trupit.	<p>a)E xhonglojnë tullumbacen pa rënë në tokë për 2 minuta dhe e mbajnë në drejtpeshim për 1 minutë me tri pjesët e trupit.</p> <p>b)Xhonglojnë 1.5 minuta. E mbajnë në drejtpeshim 45 sekonda me të tria pjesët e trupit.</p> <p>c)Xhonglojnë 1 minutë dhe e mbajnë në drejtpeshim 30 sek.</p>
3.	Me topa llastiku	<p>a) Hedhja dhe pritja e topit nga vendi me çifte, duke e rritur largësinë.</p> <p>b) Goditje e shenjave të ndryshme në lartësi e largësi,</p>	Të demonstrojnë hedhjen dhe pritjen e topit nga vendi dhe të godasin shenjat e vendosura në largësi të caktuar (8-12m).	<p>a) E hedhim dhe e presin topin në largësi 20 m dhe nga 6 shenja godasin 4.</p> <p>b) E hedhin dhe e presin në largësi 15m dhe godasin 3</p>

4.	Me shkopinj gjimnastikorë.	<p>duke rritur largësinë.</p> <p>a) Mbajtja e shkopit para-poshtë me krahë të shtrirë dhe rrotullim i shpatullave pas, me “kapse të gjerë”</p> <p>b) si në a), por duke ngushtuar kapjen dalëngadalë.</p>	<p>Demonstrojnë kalimin e shkopit prapa (me kapje të ndryshme) me një shumëfish që rritet.</p> <p>Të demonstrojnë goditjen e topit në largësi dhe ta xhonglojnë atë me të dyja duart për një kohë të caktuar (pa zënë në tokë).</p>	<p>shenja.</p> <p>c) E hedhin dhe e presin në largësi 10 m dhe godasin 2 shenja.</p> <p>a) E kalojnë shkopin disa herë nga para prapa me kapje të gjerë dhe sa gjerësia e supeve</p> <p>b) E kalojnë shkopin disa herë nga para prapa dhe anasjelltas me kapje të gjerë dhe afër gjerësisë së supeve.</p> <p>c) E kalojnë shkopin disa herë vetëm me kapje të gjerë.</p>
5.	Me topa sfungjeri e raketë.	<p>a) Hedhja e topit para – lart dhe goditja me raketë në largësi.</p>	<p>Të demonstrojnë goditjen e topit në largësi dhe ta xhonglojnë atë me dy duart për një kohë të caktuar (pa zënë në tokë).</p>	<p>a) E godasin topin me forcë dhe ose e xhonglojnë për 20 sekonda pa rënë në tokë.</p> <p>b) E godasin topin me forcë mesatare dhe e xhonglojnë për 15 sek.</p> <p>c) Si në b), por me pak forcë dhe 10 sek.</p>
6.	Me parashutë të vogël	<p>a) Hedhja e parashutës nga vëndi në largësi e lartësi.</p> <p>b) Hedhja dhe pritja e parashutës me duar.</p>	<p>Të demonstrojnë hedhjen e parashutës në lartësi sa më të madhe dhe pritjen e saj me duar pa rënë në tokë.</p>	<p>a) Mbas hedhjes, parashuta bie në tokë mbas 5-6 sekondash dhe kapet me duar.</p> <p>b) Parashuta bie pas 3-4</p>

7.	Me rrathë gjimnastikorë	<p>a) Rrotullimi i rrethit me krah (i majtë, i djathtë).</p> <p>b) Rrokullisja e rrethit në tel, nëpër piketa të vendosura zig – zag</p>	<p>Të demonstrojnë rrotullimin e rrethit me dy krahë dhe rrokullisjen e tij me tel në një krah që rritet.</p>	<p>sekondash dhe kapet me vështirësi.</p> <p>c) Si në b), por parashuta bie për 2 sekonda dhe nuk kapet.</p> <p>a) E rrotullojnë me krah për 20 sek. dhe e rrokullisin zigzag në largësi 30 m.</p> <p>b. Si në a), por për 15 sek e 25 m.</p> <p>c) Si në b), por në 10 sek e 20 m.</p>
8.	Me shishe gjimnastikore	<p>a) Rrotullimi me dy duar i dy shisheve, që mbahen të varura midis gishtit tregues dhe të mesit (të përkulur).</p> <p>b) Hedhja dhe pritja e dy shisheve (me partner) nga vendi dhe në largësi të caktuar.</p>	<p>Të rrotullojnë njëkohësisht dy shishet për një kohë që rritet dhe t'i hedhin e t'i presin ato disa herë (pa rënë në tokë) nga një largësi që rritet (2 –3 m)</p>	<p>a) I rrotullojnë shishet me lirshmëri e shpejtësi. I hedhin dhe i presin të paktën 4 herë (pa rënë në tokë) në largësinë 3 m.</p> <p>b) si në a), por tri herë dhe në largësi 2 m.</p> <p>c) si në b), por 2 herë në largësi 2 m.</p>
9.	Me trup të lirë	<p>a) Nga drejtqëndrimi, prekja e objekteve me dorën e majtë e të djathtë, në lartësi (nga vendi) pa kërcim.</p>	<p>Të arrijnë të prekin disa objekte në lartësi të ndryshme duke u zgjatur, herë në të majtën e herë në të djathtën.</p>	<p>a) Prekin me të majtën e të djathtën 3 objekte në lartësi të ndryshme.</p> <p>b) Prekin 2 objekte.</p> <p>c) Prekin 1 objekt.</p>

4.LOJËRA LËVIZORE

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
1.	Lojëra për aftësitë bashkërenduese	<ul style="list-style-type: none"> ❖ “Rrjeta e peshkatarit” ❖ “Përpiqu të kapësh topin” ❖ “Luftash me top” ❖ “Sulmuesit dhe mbrojtësi” <p>Shënim : Mësuesi mund të përdorë edhe lojëra të tjera që kërkojnë shfaqjen e aftësive bashkërenduese.</p>	Të shfaqin aftësi bashkërenduese të lëvizjeve, duke bashkëpunuar me partnerin, pa dëmtuar kundërshtarët	<p>a) Shfaqin qartë aftësi bashkërenduese dhe bashkëpunojnë në lojë.</p> <p>b) Shfaqin pjesërisht aftësi bashkërenduese, por bashkëpunojnë në lojë.</p> <p>c) Kanë ngadalësi në aftësitë bashkërenduese dhe vështirësi në bashkëpunim.</p>
2.	Lojëra për shpejtësinë e shkathtësinë.	<ul style="list-style-type: none"> ❖ “Lepuri dhe zagari” ❖ “Stafetë me ndërrim sendesh ❖ “Ta lashë” ❖ “Ujku, delet dhe çobani”. 	Të shfaqin shkathtësi dhe shpejtësi në veprimet lëvizore të lojës, duke respektuar rregullat e lojës dhe kundërshtarin.	<p>a) Shfaqin qartë shpejtësi dhe shkathtësi.</p> <p>b) Shfaqin me hope shpejtësi e shkathtësi.</p> <p>c) Shfaqin ngadalësi në veprimet e lojës dhe vështirësi për t’u orientuar në kohë.</p>
3.	Lojëra të reagimit të shpejtë dhe të vëmendjes	<ul style="list-style-type: none"> ❖ “Viganët dhe shkurtabiqët” ❖ “Lepuri dhe zagari” ❖ “Qëndro në vend” ❖ “Kush e ka shaminë” 	Të alternojnë reagimet e shpejta lëvizore me vëmendjen, duke respektuar rregullat e lojës.	<p>a) Realizojnë alternim shumë të mirë.</p> <p>b) Realizojnë alternim të mirë.</p> <p>c) Në disa raste nuk arrijnë të alternojnë reagimet e vëmendjes.</p>
4.	Lojëra të drejtpeshimit dinamik e të saktësisë	<ul style="list-style-type: none"> ❖ “Goditja e shisheve nga qëndrimi në gjysmë sferë”. ❖ “Shpatash mbi tra” ❖ Lufta e gjelave mbi stol” ❖ “Gjuajtaj e topit me këmbaleca” 	Të shfaqin aftësi lëvizore në drejtpeshim dhe saktësi, duke përdorur mjete të ndryshme.	<p>a) Shfaqin qartë aftësitë e drejtpeshimit e të saktësisë</p> <p>b) I shfaqin me hope aftësitë.</p> <p>c) Nuk arrijnë sa duhet të alternojnë drejtpeshimin dhe saktësinë.</p>

5. VALLËZIMI RITMIK

Nr.	NËNLINJA	PËRMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
1.	Lëvizjet me 4 hapa në të katra drejtimet	Lëvizjet nga 4 hapa në drejtime të ndryshme, pa shoqërimin e krahëve. Të njëjtat lëvizje me shoqërimin e krahëve dhe me kthime të ndryshme.	Formimi i shprehive bazë të ritualit dhe i lëvizjeve të thjeshta. Mësimi i lëvizjeve nga 1 hap.	a) Demonstron lëvizjet e plota me muzikë me kthime të ndryshme dhe më kërcime të ndryshme gjatë ekzekutimit b) Lëvizjet bëhen më të shpejta, me muzikë dhe me lëvizjet e krahëve në të gjitha drejtimet c) Demonstron me ngadalësi lëvizjet në drejtime të ndryshme.
2.	Kompozimi i një kompleksi ritmik me 4 hapa.	Me ndihmën e mësuesit jepen ushtrimet e kompleksit në tërësi dhe pastaj mësohet pjesë – pjesë, nga lëvizja në lëvizje. Të gjitha lëvizjet në fillim bëhen me ngadalësi, pa muzikë dhe pa shoqërimin e lëvizjes së krahëve. Më pas ushtrimet të lidhura me njëri-tjetrin në formën e kompleksit me muzikë dhe me lëvizjen e krahëve.	Përforcimi i shprehive të ritmit dhe lidhja e elementeve të ndryshme të vallëzimit me lëvizjen e krahëve.	a) Kompleksi në tërësi me muzikë dhe me lëvizjen e krahëve. b) Lëvizjet e kryera dhe të lidhura me njëra tjetrën pa muzikë dhe pa lëvizjen e krahëve c) Demonstrimi i ushtrimit të kompleksit me shumë përsëritje.
3.	Bashkërendimi i lëvizjeve të vallëzimit ritmik me muzikë	Bashkërendim i plotë me 1 hap, me 2 hapa dhe me 4 hapa të shoqëruara me lëvizje krahësh, me kërcime dhe me	Mësimi i lëvizjeve të ndryshme ritmike me nga 4 kohë dhe lidhja e tyre me elemente të tjera, gjithashtu	a) Demonstrimi i rregullt i lëvizjeve dhe me ritëm të përsosur. Lëvizjet bëhen me harmoni dhe me estetikë.

		kthime të ndryshme.	lidhja e tyre me kërcime dhe kthime të ndryshme.	b) Demonstrimi i bashkërendimit të lëvizjeve me ritëm normal. c) Demonstrimi i bashkërendimit me disa gabime në lëvizje dhe me ritëm jo të mirë.
--	--	---------------------	--	---

6. VEPRIMTARI SPORTIVE

6.1 GJIMNASTIKË

Nr.	NËNLINJA	PËRMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
1. 1.1	AKROBACI Perkundje para - prapa	Nga ndenja e mbledhur, përkundje e trupit para e prapa i mbledhur	Të mësohet të kryejnë teknikisht përkundjen e trupit para e prapa, i mbledhur	a) Shfaq siguri në kryerjen me saktësi të përkundjes së trupit para e prapa, i mbledhur nga pozicione fillestare të ndryshme b) Kryen përkundjen e trupit para e prapa, i mbledhur radhazi me ngritje në qëndrim i mbledhur pa ndihmën e shtytjes me duar nga toka c) Kryerja e përkundjes së trupit para e prapa, i mbledhur me ndihmën e shtytjes me duar nga toka.
1.2	Vertikale mbi shpatulla	Nga qëndrimi shtrirë në shpinë, vertikale mbi shpatulla-qëndrim.	Të mësohen të kryejnë teknikisht vertikalen mbi shpatulla.	a) Shfaq siguri në kryerjen e saktë të vertikales mbi shpatulla nga pozicione fillestare të ndryshme. b) Kryen vertikalen mbi shpatulla, rënie para i mbledhur e ngritje nga qëndrimi i mbledhur. c) Kryen vertikalen mbi

1.3	Vertikale mbi kokë	Nga qëndrimi mbledhur, vertikale mbi kokë.	Të kryejnë mirë teknikisht vertikalen mbi kokë.	shpatulla nga qëndrimi i shtrire në shpinë a) Shfaq siguri në kryerjen e saktë të vertikales mbi kokë nga pozicione fillestare të ndryshme. b) Kryen vertikalen mbi kokë nga qëndrimi i mbledhur i trupit. c) Kryen vertikalen mbi kokë me shtytjen e këmbëve.
1.4	Kapërdimje para e prapa e mbledhur	Nga qëndrimi këmbëmbledhur kapërdimje para e prapa mbledhur	Të mësojnë të kryejnë teknikisht kapërdimjen para e prapa, i mbledhur	a) Shfaq siguri në kryerjen e saktë të kapërdimjes para me kërcim (fluturimthi), si dhe të kapërdimjes prapa, i mbledhur. b) Kryen kapërdimjen para e prapa, i mbledhur nga pozicione fillestare të ndryshme. c) Kryen kapërdimjen para e prapa, i mbledhur në rrafshin e pjerrët.
1.5	Qëndrimi në urë	Nga qëndrimi shtrirë në shpinë urë – qëndrim	Të kryejmë teknikisht qëndrimin në urë	a) Kryen i sigurt dhe me saktësi teknikisht qëndrimin në urë nga pozicione fillestare të ndryshme. b) Kryen urën, nga qëndrimi shtrirë në shpinë.

1.6	Vertikale mbi duar	Nga drejtqëndrimi mbi një rën këmbë, tjetra para-poshtë, krahët lart, kalim në vertikale mbi duar	Të mësojnë teknikisht vertikalen mbi duar	c) Kryen urën nga varja në qëndrim në shpinë. a) Shfaq siguri në kryerjen e kalimit në vertikale mbi duar nga pozicione fillestare të ndryshme. b) Kryen vertikalen mbi duar nga mbështetja para me shpinë nga shpinorja, ecje e njëpasnjëshme me këmbë e duar deri në pozicionin vertikal. c) Kryen vertikalen mbi duar me ndihmën e partnerit.
1.7	Rrotullim anash	Nga qëndrimi me këmbë e krahë të hapura anash rrotullim anash	Të kryejnë teknikisht saktë rrotullimin anash	a) Kryen i sigurt rrotullimin anash nga pozicione të ndryshme fillestare. b) Kryen rrotullimin anash me vendosjen e duarve në stol. c) Kryen rrotullimin anash me ndihmë të partnerit.
1.8	Drejttrashimet (ekulibret) -Ekulibër ballor, brinjor dhe shpinor	Drejttrashimet (ekulibret) -Ekulibër ballor, brinjor dhe shpinor.	Të mësojnë të kryejnë saktë teknikisht tri llojet e ekulibreve (ballor, brinjor dhe shpinor).	a) Shfaq siguri në kryerjen e saktë të të tria llojeve të ekulibrit. b) Kryen të tria llojet e ekulibreve me vendosjen e dorës në shpinore. c) Kryen të tria llojet e ekulibreve me ndihmën e partnerit.

1.9	Lojë në formë stafete, në grupe me elemente dinamike të akrobacisë	Elemente dinamike të programit të akrobacisë.	Të mësojnë të kryejnë shpejt dhe saktë elemente akrobatike dinamike.	<p>a) Shfaq siguri në kryerjen e saktë të elementeve akrobatike dinamike radhazi dhe me shpejtësi maksimale në përbërje të grupit.</p> <p>b) Shfaq pasiguri në kryerjen e elementeve akrobatike dinamike radhazi në përbërje të grupit dhe ka rritje të kohës së kryerjes së tyre.</p> <p>c) Kryen mbi 50 % të elementeve akrobatike dinamike.</p>
1.10	Gërshetim me 7-8 elemente akrobatike të programit	Gërshetim me 6-8 elemente akrobatike të programit.	Të mësojnë të kryejnë gërshetime të elementëve akrobatikë të programit	<p>a) Shfaq siguri në kryerjen e elementeve të gërshetuara, të lidhura radhazi në përbërje në akrobaci.</p> <p>b) Shfaq pasiguri në kryerjen e elementeve të gërshetuara në akrobaci, të lidhura radhazi në përbërje.</p> <p>c) Kryen mbi 50 % të elementeve të gërshetuara.</p>
2. 2.1	HEKUR(I ULËT 130-150cm) Kapjet me duar dhe llojet e tyre	Kapjet (si mënyrë e të kapurit të veglës me duar) dhe llojet e tyre: - kapje nga sipër, e zakonshme, - kapje nga poshte,	Të mësojnë të kryejnë me saktësi mënyrat e kapjeve me duar të veglës së hekurit.	<p>a) Shfaq siguri në kryerjen me saktësi të mënyrave të shumta të kapjeve me duar të veglës dhe lëvizjet lëkundëse që i shoqerojnë ato.</p>

2.2	Varjet dhe mbështetjet në hekur	<ul style="list-style-type: none"> - kapje e përzier, - kapje e kryqëzuar, - kapje e përqëndruar, - kapje e ngushtë dhe e gjerë. <p>Varjet janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - varje, - varje në qëndrim, - varje i palosur, - varje shpinore, - varje shaluar, - varje me gropën e gjurit, - varje me kapje të përdredhur. <p>Mbështetjet janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mbështetje para (ballore), - mbështetje prapa (shpinore), - mbështetje shaluar. 	Të mësojnë të kryejnë teknikisht saktë pozicionet bazë të punës në këtë vegël, të tilla si: llojet e ndryshme të varjeve dhe të mbështetjeve.	<p>b) Njih e zbaton në përgjithësi mirë llojet e kapjeve dhe lëvizjet lëkundëse që i shoqërojnë ato.</p> <p>c) Njih disa nga llojet e kapjeve dhe shfaq pakujdesi në zbatimin e tyre të përpiktë.</p> <p>a) Shfaq siguri në kryerjen e saktë të pozicioneve bazë të punës në këtë vegël.</p> <p>b) Njih e kryen në përgjithësi mirë pozicionet bazë të punës në këtë vegël.</p> <p>c) Njih disa nga pozicionet bazë të punës në varje dhe mbështetje në veglen e hekurit.</p>
2.3	Lëkundjet (në varje dhe mbështetje)	<p>Lëkundjet në varje, në varje në qëndrim me ecjen e njëpasnjëshme të këmbëve në tokë, si dhe në gropën (gropat) e gjurit.</p> <p>Lëkundjet në mbështetjet para, prapa dhe me kalimin e këmbës anash në mbështetje shaluar.</p>	Të mësojnë të kryejnë teknikisht me saktësi lëkundjet e trupit në varje dhe mbështetje.	<p>a) Demonstron siguri në kryerjen e saktë të lëkundjeve në varje dhe në mbështetje me amplitudë optimale.</p> <p>b) Kryen në përgjithësi lëkundjen në varje dhe mbështetje me amplitudë të vogël.</p> <p>c) Kryen lëkundjen nga qëndrimi në varje në ecjen e njëpasnjëshme të këmbëve</p>

2.4	Ngritjet (nga varja në mbështetje)	Nga qëndrimi në varje ngritja me rrotullim prapa në mbështetje dhe nga varja me gropën e gjurit ngritje me mbështetje shaluar.	Të mësojnë të kryejnë teknikisht saktë ngritjen me rrotullim prapa në mbështetje dhe nga varja me gropën e gjurit ngritje në mbështetje shaluar.	dhe me gropën e gjurit. a) Shfaq siguri në kryerjen e saktë të ngritjes me rrotullim prapa në mbështetje dhe nga varja me gropën e gjurit ngritje me mbështetje shaluar. b) Kryen në përgjithësi mirë e me pak gabime në ekzekutim ngritjet e lartpërmendura. c) Kryen me ndihmën e partnerit të dyja ngritjet e lartpërmendura.
2.5	Daljet	Nga qëndrimi në varje dalje me hark dhe nga mbështetja shaluar dalje me kthim 90° (270°) me kthimin e këmbës para.	Të mësojnë të kryejnë teknikisht saktë daljen me hark nga qëndrimi në varje, si dhe daljen nga mbështetja shaluar me kalimin e këmbës para me kthim 90° e 270°	a) Shfaq siguri në kryerjen e saktë të daljes me hark nga qëndrimi në varje, si dhe daljen nga mbështetja shaluar me kalimin e këmbës para me kthim 90° e 270°. b) Kryen në përgjithësi mirë daljet e lartpërmendura me ndonjë gabim teknik në ekzekutimin e tyre. c) Kryen me ndihmën e partnerit daljet e mësipërme.
2.6	Gërshetimi me 4-6 elemente të mësuara të programit	Gërshetimi me 4-6 elemente të mësuara të programit.	Te mësojnë të kryejnë gërshetimin me elemente të programit.	a) Shfaq siguri në kryerjen e elementeve të lidhura radhazi në përbërje të gërshetimit të tyre në hekur. b) Shfaq pasiguri në kryerjen

2.7	Lojë në formë stafete në grupe me elemente të mësuara në hekur	Elemente të programit në hekur.	Të mësojnë të kryejnë shpejt dhe saktë elementet e programit në hekur.	e elementeve në përbërje të ushtrimit të gërshtuar. c) Kryen mbi 50 % të elementeve të ushtrimit të gërshtuar.
3.1	PARALELE Mbështetjet dhe varjet	Mbështetje mbi krahë, parakrahë, me krahë të mbledhur dhe mbi duar. Varje, varje në qëndrim i palosur, varje i shtrirë e varje në shpinore.	Të mësojnë teknikisht saktë pozicionet bazë të punës në paralele, të tilla si: llojet e ndryshme të varjeve e të mbështetjeve.	a) Shfaq siguri në kryerjen e saktë të pozicioneve bazë të punës në këtë vegël. b) Ndjen e kryen në përgjithësi mirë pozicionet bazë të punës në këtë vegël. c) Ndjen disa nga pozicionet bazë të punës në varje e mbështetje në paralele.
3.2	Zhvendosje me duar në mbështetje	Ecje mbi duar para, prapa në mbështetje gjatë gjithë gjatësisë së paraleles. Nga qëndrimi në mbështetje	Të mësojnë teknikisht kryerjen e ecjes mbi duar në mbështetje në tërë gjatësinë e paraleles, si	a) Shfaq siguri në kryerjen e saktë të zhvendosjeve para e prapa në tërë gjatësinë e paraleleve.

		<p>ndenjuri me këmbë të hapura anash, kalim i duarve në mbështetje para e rrjedhshëm bashkimi i këmbëve prapa e në lëkundjen para, hapja e këmbëve në ndënje.</p>	<p>dhe nga mbështetja ndenjuri me këmbë të hapura anash, kalim në mbështetje para, bashkim i këmbëve prapa e në lëkundjen para ndënje me këmbë të hapura anash.</p>	<p>b) Shfaq siguri në kryerjen e zhvendosjeve para e prapa dhe jo në të gjithë gjatësinë e paraleles e përshkon. c) Kryen pjesërisht zhvendosjet para e prapa me të meta të theksuara në përgatitjen fizike.</p>
3.3	Lekundjet në mbështetje	<p>Lëkundje në mbështetje mbi krahë, parakrahë, me krahë të mbledhur dhe mbi duar.</p>	<p>Të mësojnë të kryejnë teknikisht me saktësi lëkundjet në mbështetje mbi krahë , parakrahë, me krahë të mbledhur dhe mbi duar.</p>	<p>a) Shfaq siguri në kryerjen saktë të lëkundjeve në mbështetje mbi krahë, parakrahë, me krahë të mbledhur e mbi duar me amplitudë maksimale. b) Kryen lëkundjet në mbështetje me amplitudë mesatare. c) Shfaq pasiguri dhe kryen lëkundjet në mbështetje me amplitudë të vogël.</p>
3.4	Dalje në lëkundjen para e prapa nga mbështetja	<p>Dalje në lëkundjen para e prapa nga mbështetja.</p>	<p>Të mësojnë të kryejnë teknikisht me saktësi daljet në lëkundjen para e prapa nga mbështetja mbi duar.</p>	<p>a) Kryen daljet me siguri në lëkundjen para e prapa me amplitudë optimale. b) Kryen daljet e lartpërmëndura me amplitudë mesatare. c) Shfaq pasiguri në kryerjen e daljeve që shoqërohen nga një amplitudë e vogël e</p>

3.5	Ushtrimi i gërshetuar me 4-6 elemente të programit.	Ushtrimi i gërshetuar. me 4-6 elemente nga programi.	Të mësojmë të kryejmë teknikisht saktë ushtrime të gërshetuar me elemente të programit	lëkundjes. a) Shfaq siguri në kryerjen e elementeve të lidhura radhazi në përbërje të ushtrimit të gërshetuar. b) Shfaq pasiguri në kryerjen e elementeve të përbërjes të ushtrimit të gërshetuar. C. Kryen ushtrimin e gërshetuar pjesërisht e me gabime teknike.
3.6	Lojë në formë stafete në grupe me elemente të programit	Me elemente të mësuar të programit në paralele.	Të mësojmë të kryejnë shpejt dhe saktë elementet e programit në paralele.	a) Shfaq siguri në kryerjen e saktë të elementeve radhazi dhe me shpejtësi maksimale në përbërje të grupit. b) Shfaq pasiguri në kryerjen e elementeve radhazi në përbërje të grupit. c) Kryen pjesërisht e me gabime teknike elementet e ushtrimit të gërshetuar në përbërje të grupit.
4 4.1	KËRCIME (KALUÇI) Kërcime të thjeshta	Kërcime të thjeshta me të dyja këmbët në vend, së gjati, nga lart poshtë (të thellësisë) etj.	Të mësojnë të kryejnë më kërkesa teknike specifike kërcimet e thjeshta me të dyja këmbët në vend, së gjati, nga lart poshtë (të	a) Shfaq cilësi me kërkesa të larta teknike përsa i përket gjatë kërcimit e lartësisë së tij.

4.2	Me 5-6 hapa vrull kërcim në pedanë me krahë lart, përballë murit	Me 5-6 hapa vrull kërcim mbi pedanë me krahët lart,përballë murit.	thellësisë) etj. Të mësojnë të kryejnë teknikisht saktë kërcimin mbi pedanë nga vrulli i përshpejtuar me 5-6 hapa, përballë murit.	b) Kryen në përgjithësi mirë llojet e kërcimeve të thjeshta me pak gabime. c) Kryen llojet e kërcimeve të thjeshta në kushte lehtësuese (me trampolinë, p./elas.). a) Shfaq siguri në bashkërendimin e vrullit me hapin kërcyes mbi pedanë e kërcim energjik lart. b) Kryen në përgjithësi mirë kërcimin me vrull me ndonjë gabim të vogël në bashkërendim. c) Kryen kërcimin me vrull në kushte lehtësuese (me rrahje ne p./elastike, minitrampolinë etj.)
4.3	Me 5-6 hapa vrull kërcim mbi pedanë e rënie barkas mbi një stivë dyshekësh (ose mbi tavbolinën gjimnastikore të lartë 120-130 cm)	Me 5-6 hapa vrull kërcim mbi pedanë e rënie barkas mbi një stivë dyshekësh (ose mbi tavbolinën gjimnastikore të lartë 120-130 cm).	Të mësojmë të kryejnë teknikisht hedhjen e trupit të shtrirë mbi stivën me dyshekë (fluturimi i parë) nga vrulli i përshpejtuar.	a) Shfaq siguri në ndërthurjen e tri fazave të para të kërcimit (vrulli-rrahja-fluturimi). b) Kryen në përgjithësi mirë fazat e para të kërcimit në shërbim ”të fluturimit” c) Kryen në kushte lehtësuese ose me ndihmën e partnerit tri fazat e para të kërcimit.
		Nga pozicioni start noti,	Të mësojnë të kryejnë	a) Shfaq siguri në kryerjen

4.4	Nga pozicioni start noti, kërcim këmbadorazi në tokë mbi stol ose mbi kalin së gjati, me këmbë të hapura anash	kërcim këmbadorazi në tokë mbi stol ose mbi kalin së gjati me këmbë të hapura anash.	teknikisht kërcimin këmbadorazi në tokë radhazi.	teknikisht saktë të kërcimit këmbadorazi në tokë mbi stol ose mbi kalin së gjati. b) Kryen në përgjithësi mirë bashkërendimin këmbadorazi me kërcim në tokë, mbi kalë. c) Kryen kërcimin këmbadorazi në kushte lehtësuese ose me ndihmën e partnerit.
4.5	Me 4-6 hapa vrull kërcim mbi stivën e dyshekëve (ose mbi tavolinën gjimnastikore), vendosje e këmbëve të hapura anash e kërcim me krahët lart e rënie i fiksuar me këmbët në tokë	Me 4-6 hapa vrull kërcim mbi stivën e dyshekëve (ose mbi tavolinën gjimnastikore), vendosje e këmbëve të hapura anash e kërcim me krahët lart e rënie i fiksuar me këmbët në tokë.	Të mësojnë të kryejnë teknikisht saktë fazat përbërëse të kërcimit, të lidhura së bashku në kushte lehtësuese	a) Shfaq siguri në kryerjen teknikisht saktë të fazave të kërcimit me këmbë të hapura anash mbi stivën e dyshekëve (ose mbi tavolinën gjimnastikore). b) Kryen në përgjithësi mirë teknikisht fazat përbërëse të kërcimit me këmbë të hapura anash. c) Kryen në kushte lehtësuese ose me ndihmën e partnerit fazat përbërëse të kërcimit me këmbë të hapura.
4.6	Nga vrulli optimal kërcim i kaluçit së gjati (së gjeri) me këmbë të hapura anash (lartësia e kaluçit 110-120 cm)	Nga vrulli optimal kërcim i kaluçit së gjati (së gjeri) me këmbë të hapura anash (lartësia e kaluçit 110-120 cm).	Të mësojnë të kryejnë teknikisht me saktësi kërcimin e kaluçit së gjati (së gjeri) me këmbë të hapura anash.	a) Shfaq siguri në kryerjen e kërcimit të kaluçit me këmbë të hapura anash sipas kërkesave teknike. b) Kryen në përgjithësi mirë kërcimin e kaluçit me këmbë

4.7	Lojë në formë stafete në grupe me kërcimin e kaluqit (shokut) me këmbë të hapura anash	Lojë në formë stafete në grupe me kërcimin e kaluqit (shokut) me këmbë të hapura anash.	Të mësojnë të kryejnë teknikisht dhe shpejt kërcimin e kaluqit (shokut) me këmbë të hapura anash në grupe në formë stafete.	<p>të hapura anash me ndonjë gabim të vogël teknik.</p> <p>c) Kryen kërcimin e dhënë në kushte lehtësuese ose me ndihmën e partnerit.</p> <p>a) Shfaq siguri në shpejtësi në kryerjen e kërcimit të kaluqit (shokut) në përbërje të grupit.</p> <p>b) Kryen në përgjithësi mirë kërcimin e kaluqit (shokut) me këmbë të hapura anash me ndonjë pasaktësi në përbërje të grupit.</p> <p>c) Kryen kërcimin e kaluqit (shokut) me këmbë të hapura anash, jo në përbërje të grupit.</p>
-----	--	---	---	---

6.2 VOLEJBOLL

Nr.	NËNLINJA	PËRMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
1.	Njohuri për lojën e volejbollit.	<p>Nxënësit të mësojnë rregullat kryesore të lojës:</p> <p>Të mësojnë hapësirat bazë të fushës: zonën e sulmit , zonën e mbrapme, zonën e shërbimit.</p> <p>Të mësojnë kërkesat kryesore të rregullores teknike: faullat e ndryshme në elementet teknike të sulmit , të mbrojtjes dhe të kryerjes së shërbimit.</p>	<p>Në fund të klasës VI nxënësit të dijnë:</p> <p>Përmasat kryesore të fushës, të rrjetës e të topit.</p> <p>Të kuptojnë e të zbatojnë kërkesat e rregullores teknike për elementet bazë të pasimit me dy duar nga sipër e dy duar nga poshtë.</p> <p>Të dinë të reagojnë ndaj sinjaleve kryesore të arbitrit.</p> <p>Të dinë që të përgjigjen me sinjale, duke dalluar njërin nga tjetri qëndrim volejbollisti.</p>	<p>a) Shfaq aftësi për t'u përshtatur me rregullat e thjeshta të lojës së volejbollit dhe me sinjalet për të komunikuar me arbitrin.</p> <p>b) Zbaton përgjithësisht me saktësi rregulloren e lojës dhe reagon ndaj faulleve të ndryshme teknike.</p>
2.	Qendrimet dhe lëvizjet në fushë	<p>Nxënësit të mësojnë qëndrimet në fushë, si dhe të lëvizin për t'u afruar tek topi që fluturon në largësi të afërta me të.</p> <p>Të mësojnë se si të qëndrojnë kryesisht në pozicionin e mesëm e të lartë, dhe pak në pozicionin e ulët.</p>	<p>Të dinë sesi të marrin pozicionin dhe qëndrimin bazë gjatë pasimit.</p> <p>Të dinë lëvizjen paraprapa e anash me hapa, për të rrahur topa që vijnë në afërsi të tyre ose duke i pasuar tek shoku.</p> <p>Në përfundim të të mësuarit të qëndrimeve e të lëvizjeve në fushë. Nxënësit</p>	<p>a) Nxënësi njeh mënyrat si qëndrohet në fushë, para kryerjes së elementeve të lojës dhe gjatë kryerjes së tyre, si dhe shfaq bindjen se pa ndihmën e elementeve pozicionuese e çvendosëse është e pamundshme që të orientohet në fushën e lojës.</p> <p>b) Zbaton në përgjithësi mirë</p>

3.	Pasimet e topit.	<p>Të mësojnë si të lëvizin me hapa para prapa e anash për të zotëruar topa te thjeshte ne afërsi të vetes.</p> <p>Nxënësit të mësojnë pasimet me dy duar nga sipër.</p> <p>Të mësojnë teknikën e pasimit me dy duar nga sipër para.</p> <p>Të mësojnë pasimet me dy duar nga sipër anash djathtas majtas. .</p> <p>Të mësojnë pasimet me dy duar nga sipër prapa kokës.</p>	<p>të dinë t'i përshtasin ato në lojërat e thjeshta parataktike më numër të reduktuar lojtarësh:1x 1, 2 x 2, 3 x 3. Nxënësit të kuptojnë domosdoshmërinë e qëndrimeve e të lëvizjeve të rregullta në fushë për të luajtur e për të pasur përfundime të mira.</p> <p>Në përfundim të të mësuarit të pasimit me dy duar sipër, të dinë të pasojnë përballë njëri- tjetrit me saktësi;</p> <p>-të orientohen me pasime përballë njëri- tjetrit në të dyja anët e rrjetës;</p> <p>-të pasojnë me dy duar nga sipër para nga pozicioni 3 topa për gjuajtje në pozicionin 4;</p> <p>-të pasojnë me dy duar nga sipër anash, djathtas,majtas, perkatësisht në pozicionin sulmues 4 dhe 2, por duke u përqendruar më shumë te pasimet me dy duar nga</p>	<p>qëndrimit në fushë dhe lëviz deri diku në kohë për të zotëruar topin.</p> <p>a)Njeh mënyrat e pasimit me dy duar nga sipër dhe krijon bindje se pa pasimet si element nderlidhes loja e volejbollit nuk mund të funksionojë .Dobësite në pasim , janë dobësi në rezultat.</p> <p>b)Zbaton me saktësi e pastër teknikën e pasimeve nga sipër para .</p> <p>c) Zoteron pergjithësisht pasimet anësore dhe aplikon deri diku pasimet me dy duar nga sipër prapa.</p>
----	------------------	--	--	--

4.	Pritjet e topit (zotërimet)	<p>Nxënësit të mësojnë zotërimet (pritjet) e topit me dy duar nga poshtë.</p> <p>Të mësojnë teknikën e zotërimit të topit nga shërbimet e kundërshtarit .</p> <p>Të mësojnë zotërimin e topit me dy duar nga poshtë nga sulmi i kundërshtarit.</p> <p>Të mësojnë të presin topat që vijnë mbi lartësinë e kokës, me një dorë nga sipër, grushtimi, dhe me një dorë nga poshtë anash pa rënie.</p>	<p>poshtë anash nga e djathta për sulm në pozicionin 4; -të pasojnë me dy duar nga sipër prapa kokës.</p> <p>Të dinë që të presin shërbimet e kundërshtarit që kryen nga poshtë dhe të ekzekutuara nga sipër.</p> <p>Të zotërojnë topat nga loja në mbrojtje (topat e kaluar, topat e ngecur dhe gjuajtjet).</p> <p>Të dinë që të drejtojnë topat e pritur kryesisht në pozicionin 3, tek pasuesi.</p>	<p>a) Nxënësi zbaton njeqëndrimet dhe zhvendosjet në fushë dhe i përshtat ato në pritjet e topave nga shërbimi dhe nga gjuajtjet e kundërshtarit, duke i adresuar me saktësi tek pasuesi.</p> <p>b) Zbaton me saktësi pritjet e topit me dy duar nga poshtë nga shërbimet dhe sulmet e lehta dhe pergjithësisht mirë pritjet e shërbimeve të forta të kundërshtarit.</p>
5.	Shërbimet	<p>Nxënësit të mësojnë shërbimet tip tenis dhe shërbimin nga poshtë anash dhe përpara.</p>	<p>Të dinë të kryejnë shërbimet nga poshtë.</p> <p>Të kryejnë shërbimet tip tenis nga sipër.</p> <p>Të alternojnë herë njërin dhe herë tjetrin shërbim sipas kërkesave taktike të lojës.</p>	<p>a) Shfaq bindje të plota mbi rëndësinë e shërbimit në lojë.</p> <p>b) Zbaton pergjithësisht mirë teknikat e shërbimeve si nga sipër, dhe nga poshtë, por pa kërkesa taktike për të adresuar shërbimin në pika të caktuara.</p>

6.	Lojë mësimi	<p>Të përvetësojnë nxënësit rregullat e minivolejbollit.</p> <p>Të njohin lojërat lëvizore parasportive</p> <p>Të mësojnë të luajnë volejbollin e madh 6 x 6.</p>	<p>Të përshtaten në lojën e minivolejbollit drejtpërdrejt me kundërshtarë.</p> <p>Të dinë lojërat parataktike në ndihmë të volejbollit.</p> <p>Të dinë të garojnë me njëritjetrin: kush mban më shumë topin mbi kokë, në mur me grupe dyshe apo treshe etj.</p> <p>Të dinë të lozin volejboll 6 kundër 6.</p>	<p>a) Të shfaqin bindje të qarta për lojën e volejbollit si mjet argëtimi, regreacioni e garimi.</p> <p>b) Të zbatojnë në praktikën e lojës elementet e mësuara të pasimit, shërbimit e zotërimit të topit me dy duar nga poshtë, në përshtatje me rregulloren teknike (rregullat e thjeshta).</p>
----	-------------	---	---	--

6.3. ATLETIKË

Nr	NËNLINJA	PËRMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
1 1.1	Vrapimet Vrapime shpejtësie	Ushtrime speciale vrapimi: - me gjunjët lart - me thembrat prapa - luhatje e krahëve në vend Përshejtime nëlargësi 20-30 m mbi vija të drejta Nisje nga pozicione të ndryshme pas sinjalit dëgjimor, vrapim 5-10 m. Nisje nga pozicioni në këmbë vrapime në largësi 30-50 m. Stafeta të ndryshme në formë lojërash. Stafeta sportive 4x50 m	Të fillojë mësimi i ushtrimeve speciale si pjesë e teknikës së plotë të vrapimit. Të vendosen këmbët në tokë në të njëjtin drejtim Të krijohet ndjesia e përkuljes së trupit përpara dhe shtytjes në kënd të ngushtë. Të kryhet lëvizje rrotulluese e këmbëve gjatë vrapimit Në stafeta vrapohet me ritëm shumë të lartë dhe krijohet ndjenja e bashkëpunimit dhe kolektivitetit.	a) Reagon mirë, në nisje ruan prirjen (përkuljen) e trupit përpara, bashkërendon mirë këmbë e duar. Ka përmirësim të ndjeshëm të kohës së vet në 50 m. b) Në përgjithësim realizojnë mirë të gjitha elementet teknike, por kanë ndonjë mangësi nga sa përmenden më sipër, apo përmirësim të vogël të kohës vetjake në 50 m. c) Reagim i dobët, mungesë e bashkërendimit të mirë, përmirësim i vogël i kohës në 50 m.
1.2	Vrapime qëndrueshmërie	Ecje-rendje sipas mundësive të secilit me kohëzgjatje 1-2min X 5-3 Vrapime në grupe me aftësi të përafërta 200-300 x 3 Vrapim i pandërprerë deri në 10 min.	Të bëhet frymëmarrje dhe frymënxjerrje e plotë, pa sforcim përshtatur me një numër të caktuar hapash. Të kryhen lëvizje të lirshme dhe të gjendet ritmi i përshtatshëm për të vrapuar gjatë. Të vrapohet gjatë pa kaluar në dihatje.	a) Përmirësim i gjatësisë në vrapim të pandërprerë për 6 min, duke i bashkëreduar mirë frymëmarrjen me lëvizjet harmonike b) Përmirësim i vogël i gjatësisë ose nuk ka lëvizje harmonike. c) Veprimet dhe frymëmarrja nuk janë në harmoni, si dhe

1.3	Vrapime pengesa me	<p>Kalim me vrapim i 2-3 pengesave të ulta 40-50 cm, me largësi të papërcaktuar ndërmjet tyre.</p> <p>Ushtrime speciale për këmbën sulmuese përballë shpinores ose anash 2 pengesave.</p> <p>Si më sipër për këmbën shtytëse Nga nisja në këmbë, kalimi i një pengese</p> <p>Me nisje në këmbë, kalim i tri pengesave me 3-5 hapa.</p>	<p>Të krijohet një ide e përgjithshme e teknikës së kalimit të pengesave</p> <p>Qortohen gabimet e vëna re në ushtrimin e parë me anë të ushtrimeve të veçanta.</p>	<p>përmirësimi mjaft i vogël i gjatësisë.</p> <p>a) Kalon pengesat rrjedhshëm pa ndryshime të shpejtësisë.</p> <p>b) Ka ndonjë mangësi në lëvizjet e këmbës shtytëse apo sulmuese, mban drejt trupin.</p> <p>c) Prish hapat para pengesës ose ndryshon shpejtësinë.</p>
1.4	Njohuri	<p>Njohuri të përgjithshme mbi vrapimet si ndahen (të shkurtra, të mesme e të gjata) , kur kanë filluar garat e para etj.</p>	<p>Të përcaktohet numri i hapave deri tek pengesa e parë dhe të kalohet ajo me shpejtësi.</p> <p>Të formohet një kulturë e përgjithshme teorike.</p>	
2 2.1	Kërcimet Kërcimi së gjati	<p>Vrapim, hypje mbi objekte apo prekje e objekteve të larta me kërcim.</p> <p>Lojë "Kush kalon kanalin" (dy vija në tokë që i largon vazhdimisht).</p> <p>Kërcime të plota me vrull 8-12 hapa me teknikën këmbëmbledhur.</p>	<p>Të përcaktohet këmba rrahëse.</p> <p>Të krijohet ndjesia e fluturimit.</p> <p>Të përvetësohet teknika e kërcimit këmbëmbledhur.</p>	<p>a) Kërcim i rrjedhshëm, flurudhë e lartë kërcimi, kontroll i mirë i lëvizjeve</p> <p>b) Prishje e hapave gjatë vrullit apo rrahje jo e plotë, flurudhë e ulët.</p> <p>c) Veprime të dobëta, jo të rrjedhëshme, nuk ka ndjesinë e kërcimit (fluturimit).</p> <p>a) Kërcim i rrjedhshëm, flurudhë e lartë kërcimi,</p>

2.2	Kërcim së larti	<p>Ushtrime të ndryshme kërcimi: ”indiane”, me prekje të objekteve në lartësi, hypje në objekte të larta.</p> <p>Kërcime mbi një vijë në çdo hap, një herë nga e majta , një herë nga e djathta e vijës.</p> <p>Kërcime ”gërshërë” në formë loje apo gare.</p>	<p>Të përcaktohet këmba rrahëse.</p> <p>Të mësohet lëvizja “gërshërë” e ndrrimit të këmbëve.</p> <p>Të përvetësohet teknika e plotë e kërcimit “gërshërë”.</p>	<p>kontroll i mirë i lëvizjeve</p> <p>b) Prishje e hapave gjatë vrullit apo rrahje jo e plotë, flurudhë e ulët.</p> <p>c) Veprime të dobëta, jo të rrjedhëshme, nuk ka ndjesinë e kërcimit (fluturimit).</p>
2.3	Njohuri	<p>Cilat janë garat e kërcimeve së larti e së gjati. Historik i shkurtër. Teknikat e ndryshme.</p>	<p>Të ketë njohuri të thjeshta për kërcimet.</p>	
3	Hedhjet			
3.1	Top i mbushur 200 gr	<p>Hedhje me dy duar sipër kokës me një hap para, në formë rivënie anësore.</p> <p>Si më sipër, me një dorë.</p> <p>Shtytje nga supi në formën e shtytjes së gjyles ballore.</p>	<p>Të bëhet lëvizja e trupit në drejtimin e hedhjes.</p> <p>Të bëhet lëvizja e krahut hedhës mbi kokë.</p> <p>Të bëhet zhvendosja ballore pa rrotullim të trungut.</p>	<p>a) Në përgjithësi kryen lëvizje te rrjedhshme në zbatimin e skemës së plotë të gjyles</p> <p>c) Bën shtytje vetëm me krahë ose rrotullon trungun</p> <p>c) Vrull i dobët, sforcim final i dobët.</p>
3.2	Top i mbushur 1 kg	<p>Hedhje e topit nga pozicione të ndryshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në drejtqëndrim topi mbahet me dy duar para vetes, përkulen gjunjët 	<p>Të krijohet ndjeshmëria që në hedhje punën kryesore e kryejnë këmbët.</p>	

		<p>gjysëm-këmbëmbledhur dhe hidhet topi para-lart me kërcim, duke zgjatur krahët lart.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Si ushtrimi më lart, por hedhja bëhet mbrapsh. - Hedhje me dy duar mbi kokë, në formë rivënie anësore. - Shtytje me dy duar nga gjoksi, me një hap përpara si pasimi në basketboll. <p>Shtytje nga gjoksi në formën e shtytjes së gjyles ballore. Shtytje nga pozicion anësor Teknika e plotë e shtytjes së gjyles me vrull nga pozicion anësor</p>	<p>Të përvetësohet teknika më e thjeshtë e shtytjes së gjyles</p>	
--	--	--	---	--

6.4 FUTBOLL

Nr.	Nënlinja	Përmbajtja	Objektivat	Arritjet
1.	Njohuri për lojën e futbollit	<p>Nxënësit të mësojnë rregullat e lojës.</p> <p>Të mësojnë përmasat bazë të fushës, portës dhe topit.</p> <p>Të mësojnë kërkesat kryesore të zbatimit të elementeve përbërëse të rregullores teknike: faullat e ndryshme gjatë fazave të lojës në sulm e mbrojtje.</p>	<p>Nxënësit të dinë:</p> <p>Përmasat kryesore të fushës, portës rjetës dhe topit.</p> <p>Të kuptojnë dhe të zbatojnë kërkesat e rregullores teknike për elementet bazë të goditjes së topit nga vëndi.</p> <p>Të dinë të reagojnë ndaj sinjaleve kryesore të arbitrit.</p>	<p>a)Të shfaqë aftësi për t'u përshtatur me rregullat e thjeshta të lojës në futboll dhe për të komunikuar me arbitrin me anë të sinjaleve.</p> <p>b)Zbaton në përgjithësi me saktësi rregulloren e lojës dhe reagon ndaj faullave të ndryshëm teknikë.</p>
2.	Qëndrimet dhe lëvizjet në fushë	<p>Nxënësit të mësojnë qëndrimet në fushë, si dhe të lëvizin për t'u aftësuar ndaj topit, i cili goditet nga afër.</p> <p>Të mësojnë si të vendosen në pozicione të ndryshme të fushës mbrojtje – mesfushë – sulm.</p> <p>Të mësojnë si të lëvizin në drejtime me hapa anash, para, mbrapa për të qenë sa më afër zotërimit të topit të pasuar.</p>	<p>Të dinë të përshtaten e të përgjigjen njëri-tjetrit me sinjale pozicioneve në fushë.</p> <p>Të dinë të marrin pozicione bazë gjatë pasimeve të topit.</p> <p>Të dinë të orientohen në fushë në vartësi ndaj topit, shokut e kundërshtarit gjatë pasimit.</p> <p>Të dinë të përshtasin pozicionet gjatë lojërave të thjeshta parataktike 1:1, 2:2, 3:3.</p> <p>Të kuptojnë se është e domosdoshme të dinë të</p>	<p>a)Nxënësi njeh mënyrat e vendosjes në fushë para e mbas kryerjes së elementëve teknikë duke u bindur se pa ndihmën e elementëve vendoses dhe çvendoses nuk mund të orjentoher gjatë lojës.</p> <p>b)Zbaton me rregull vendosjet përgjithësisht në fushë për t'u afruar me topin.</p>

3.	Pasimet e topit	<p>Nxënësit të mësojnë goditjet e topit nga vendi me pjesën e brendshme të këmbës.</p> <p>Të mësojnë goditjet e topit me trinën e plotë nga vendi.</p> <p>Të mësojnë udhëheqjen e topit me pjesën e brendshme të këmbës.</p> <p>Nxënësit të mësojnë goditjet e topit me trinën e plotë nga vendi.</p>	<p>vendosen për të patur më vonë rezultate gjatë lojës.</p> <p>Të dinë të pasojnë përballë njëri-tjetrit me saktësi e lehtësi.</p> <p>Të orientohen gjatë pasimit të goditjes me pjesën e brendshme përballë njëri-tjetrit qoftë dhe me pozicionet e gjuajtjes në portë.</p> <p>Të orientohen që gjatë goditjeve të topit me pjesën e brendshme të ushtrohet edhe këmba e dobët.</p> <p>Të jenë në gjendje të kryejnë goditjen me partnerin ose në grup lojtarësh.</p> <p>Të orientohen individualisht për marrjet e topit.</p> <p>Të zotërojnë topin dhe të pasojnë brenda një kuadri me trinën e plotë të këmbës.</p> <p>Të orientohen drejt për goditjet në largësi të vogla.</p>	<p>a)Nxënësi njih dhe e zbaton me saktësi pasimin me pjesën e brendshme të këmbës.</p> <p>b)Zbaton teknikën e goditjes me pjesën e brendshme të këmbës.</p> <p>c)Zotëron deri diku pasimet me pjesën e brendshme të këmbës.</p>
4.	Pasimet e topit	<p>Të mësojnë kontrollin e topit gjatë goditjes me trinën e plotë brenda një kuadrati të caktuar.</p>	<p>Të orientohen individualisht për marrjet e topit.</p> <p>Të zotërojnë topin dhe të pasojnë brenda një kuadri me trinën e plotë të këmbës.</p> <p>Të orientohen drejt për goditjet në largësi të vogla.</p>	<p>a)Nxënësi njih lëvizjet duke iu përshtatur pasimeve dhe gjuajtjeve me saktësi me trinën e plotë.</p> <p>b)Nxënësi përdor thuasje me lehtësi udhëheqjen e topit.</p> <p>c)Nxënësi zotëron deri diku udhëheqjen e topit.</p>
5.	Udhëheqjet e topit me pjesën e brendshme të këmbës	<p>Nxënësit të mësojnë udhëheqjen e topit me pjesën e brendshme të këmbës.</p> <p>Të mësojnë kontrollin e topit</p>	<p>Të orientohen drejt për goditjet në largësi të vogla.</p>	<p>c)Nxënësi zotëron deri diku udhëheqjen e topit.</p> <p>a)Nxënësi e njih dhe e zbaton udhëheqjen e topit</p>

6.	Lojë mësimore	<p>gjatë udhëheqjes drejt duke u orientuar individualisht dhe me partner.</p> <p>Të mësojnë lojërat. Të njohin rregullat e minifutbollit. Të njohin lojërat parasportive lëvizore. Të mësojnë të luajnë futboll 4 me 4, 5 me 5.</p>	<p>Të zotërojnë topin gjatë udhëheqjes të tij në territore të caktuara.</p> <p>Të kryejnë udhëheqjen e topit individualisht në çifte e grupe. Të zotërojnë udhëheqjen e topit në formë të lirë gjatë lojës.</p> <p>Të përshtaten me lojën e minifutbollit me kundërshtarë të drejtperdejtë. Të dinë lojërat parataktike në ndihmë të futbollit. Të garojnë me njëri-tjetrin kush mban më shumë topin me këmbë, me kokë. Të luajnë futboll 6 me 6, 7 me 7, 8 me 8.</p>	<p>në bashkëveprim me partnerët dhe bën gjuajtje në portë.</p> <p>a)Të kenë bindje të qarta për lojën e futbollit si mjet argëtimi, rekreacioni e garimi. Të zbatojnë në praktikën e lojës elementet e mësuara si goditjet e topit me pjesën e brendshme të këmbës, trinën e plotë dhe udhëheqjen e topit me pjesën e brendshme të këmbës, individualisht e në kushte loje, në përshtatje me rregullat teknike.</p>
----	---------------	---	---	---

6.5 BASKETBOLL

Nr.	Nenlinja	Përmbajtja	Objektivat	Arritjet
1.	Njohuri.			
1.1	Historia e basketbollit në botë dhe në vendin tonë.	Pse lindi loja e basketbollit. Si lindi dhe kush e shpiku, viti. Si erdhi në vendin tonë dhe kur u luajt e nga kush. Kampionatet e para në vendin tonë.	Të fitojë njohuri për shpikjen e lojës së basketbollit e përhapjen e tij në botë dhe në vendin tonë.	a)Të argumentojë si ishte loja në fillim, me sa vetë luhej dhe evolimi i saj, të njohë historinë e lojës në vendin tonë, të gjykojë një ndeshje. b)Të ketë njohuri për historikun e lojës në vendin tonë. c) Të katë njohuri të thjeshta për mënyrën si luhet.
1.2	Rregullorja teknike e lojës së basketbollit	Rregullat kryesore , fusha , madhësia, tabelat,topi, lojtarët. Koha e lojës dhe rregullat për zhvillimin e saj. Gjyqtarët dhe mënyra e gjykimit të lojës.	Të dijë rregullat më kryesore të lojës së basketbollit. Të dijë mënyrën e gjykimit të lojës së basketbollit me dy gjyqtarë. Të provojë gjykimin në fushë kur luajnë shokët dhe mësojnë disa shenja të gjyqtarëve.	
2.	Qendrimi dhe lëvizjet në fushë	Pozicioni i lojtarit në sulm dhe në mbrojtje.	Të fitojë njohuri për pozicionin e lojtarit në sulm dhe në mbrojtje.	a)Të demostrojë qëndrimin e basketbollistit në sulm dhe në mbrojtje, kryen pa gabime lëvizjet me hapa , vrapimet më spikante të lojtarit anësor dhe me shpinë prapa.
2.1	Pozicioni basketbollist në sulm e në mbrojtje lëvizjet me hapa.	Lëvizjet e lojtarit pa top në sulm me hap, vrapim dhe sprint. Lëvizjet e lojtarit me hapa në mbrojtje , majtas, djathtas, para, mbrapa.	Të fitojë shprehuri në lëvizjet me top dhe të vrapojë drejt. Të arrijë të lëvizë me hapa të njëpasnjeshëm (m. – d.).	b)Të demostrojë pozicionin mbrojtës, të lëvizë në mbrojtje me hapa nga vëndi. c)Të marrë pozicionin e mbrojtjes dhe të bëjë vrapime të ndryshme.

2.2	Vrapimi dhe llojet e tij	<p>Vrapimi drejt , sipas vijave të fushës.</p> <p>Vrapimi diagonal nga një cep në tjetrin.</p> <p>Vrapim në formë harku dhe sipas rrathëve në fushë.</p> <p>Vrapime anësore majtas dhe djathtas.</p>	Të njohë të gjitha llojet e vrapimit që përdor lojtari gjatë lojës.	<p>a)Të demonstrojë pasimin me një dhe dy duar nga vendi nga kraharori, koka dhe me përplasje në tokë në një nivel të kënaqshëm nga afër dhe nga larg.</p> <p>b)Të aftësohet të pasojë me një dhe dy duar nga vendi nga kraharori, larg.</p> <p>c)Të jetë i aftë të pasojë në afërsi me një e dy duar nga kraharori.</p>
3. 3.1	Pasimet. Pasimet e topit në vend në afërsi me një dhe dy duar.	<p>Pasimet nga vendi në afërsi me një dhe dy duar nga kraharori.</p> <p>Pasime nga vendi me dy duar sipër kokës.</p> <p>Pasime nga vendi e përplasje në tokë.</p>	<p>Të fitojnë njohuri për pasimin nga vendi me një e dy duar, nga kraharori.</p> <p>Të kryejnë pasime me një dhe dy duar sipër kokës nga vendi.</p> <p>Të arrijnë të pasojë me një ose dy duar me përplasje në tokë.</p>	
3.2	Pasimet e topit nga vendi me një dhe dy duar , duke rritur largësinë, si dhe duke lëvizur pas pasimit.	Pasime nga vendi me një e dy duar në largësi që vijnë e zmadhohen. Pas pasimit lojtarët levizin nga njëri grup tek tjetri.	Të gjitha llojet e pasimeve që përmendëm më lart, por duke e rritur largësinë e pasimit. Lojtarët pas pasimit zënë një	<p>a)Demonstrimi i driblimit në vend, me dorën e djathtë dhe të majtë, levizja e dorës me topin në formë suste, shikimi lart; demonstrimi i driblimit në lëvizje sipas vijes së drejtë , me hap ose lëvizje të ngadaltë.</p> <p>b)Të demonstrojë mirë driblimin</p>

<p>4. 4.1.</p>	<p>Driblimi. Driblimi në vend me dorën e djathtë dhe të majtë.</p>	<p>Driblimi në vend më dorën e djathtë. Driblimi në vend me dorën e majtë. Driblimi në vend me alternimin e të dyja duarve.</p>	<p>pozicion të ri.</p> <p>Të aftësohen të driblojnë në vend, me dorën e djathtë e të majtë , duke i alternuar ato. Gjatë driblimit shikimi të jetë lart e i saktë.</p>	<p>në vend me dorën e djathtë dhe pak me dorën e majtë; të driblojë lirshëm në lëvizje me dorën e djathtë dhe ndonjëherë me të majtën. c)Driblimi në vend dhe në lëvizje drejt me dorën e djathtë.</p>
<p>5. 5.1</p>	<p>Gjuajtja. Gjuajtja e topit nga vendi në largësi të afërt</p>	<p>Gjuajtja e topit nga vendi me një dhe dy duar nga kraharori në vend nga afër.</p>	<p>Të demonstrojnë një gjuajtje të rregullt teknikisht, me dy duar nga kraharori (afër). Të kryejë gjuajtjen me një dorë nga trupi nga afër. Të realizojë 2-3 kosha nga afër gjatë gjuajtjes.</p>	<p>a)Të egzekutojnë në mënyrë të rregullt teknikën e gjuajtjes me një dhe me dy duar nga vendi, nga 5 gjuajtje të realizojë 3. b)Të bëjë gjuajtje teknike të mirë nga afër me një dorë nga trupi, të realizojë 2 kosha nga 5 gjuajtje. c)Të gjuajë me dy duar nga afër koshit, të gjuajë me një dorë nga supi, të realizojë një kosh nga 5 gjuajtje.</p> <p>a)Të tregojnë një teknikë të mirë të elementeve të mësuara mbi 80 % e nxënësve, skuadra të lëvizë mirë në kalimet sulm–mbrojtje</p>

5.2	Gjuajtja e topit nga vendi në largësi të mesme dhe në anë të ndryshme	Gjuajtja e topit nga largësi të mesme me një dorë nga vendi në të tria planet.	Gjuajtja e topit nga largësi të mesme me një dorë nga supi, majtas e djathtas. Të realizohen 2-3 kosha nga 5 gjuajtje.	dhe anasjelltas. b)Të tregojnë se janë në gjendje të luajnë një lojë basketbolli duke ekzekutuar elementet teknike të mësuara. c)Të jenë në gjendje të bëjnë një ndeshje basketbolli ndërmjet tyre.
6.1	Lojë mësimore Lojë mësimore	Të realizojnë një lojë mësimore ku të përdorin elementet teknike të mësuara, si: lëvizjet në fushë, pasimi, driblimi dhe gjuajtje. Të aktivizohen të gjithë nxënësit e klasës si lojtarë të të dyja skuadrave duke u ndërruar.	Nxënësit të kryejnë elementet që përmban loja, të kthehen në mbrojtje kur humbin sulmin dhe të vendosin ose të shkojnë në sulm dhe të vendosen kur e zotërojnë topin. Të zbatojnë në lojë teknikat e mësuara.	
6.2.	Gjykimi i ndeshjes	Dy nxënës drejtojnë sipas rregullave një minindeshje basketbolli ndërmjet nxënësve të klasës në 10 minutat e fundit të mësimi.	Nxënësit që gjykojnë, të aftësohen sipas rregullave të basketbollit e të ndajnë detyrat si gjygtarë të minindeshjes.	

6.6 BADMINTON

Nr.	Nënlinja	Përmbajtja	Objektivat	Arritjet
7 7.1	Njohuri	Njohuri për vlerat dhe historikun e lojës së badmintonit. Njohuri për rregulloren teknike të lojës. Kërkesat kryesore të ekzekutimit teknik.	Të kenë njohuri lidhur me vlerat dhe historinë e lojës. Të pajisen me elementet më kryesore të zhvillimit të lojës. Të përvetsojnë teknikën e lojës teke dhe çift.	a)Nxënësit kanë njohuri të mira lidhur me historinë, vlerat dhe rregulloren teknike të lojës. b)Nxënësit kanë njohuri të mjaftueshme, lidhur me historinë, vlerat dhe rregulloren teknike të lojës. c)Nxënësit kanë njohuri minimale për historikun e lojës dhe rregullat teknike më kryesore.
7.2	Përshtatje me raketën dhe topin	Kapja dhe mbajtja e raketës. Përdorimi i raketës në të dyja anët e saj. Ndjeshmëria ndaj topit dhe/ose puplës. Zhonglime të strukturuar. Klime të topit/puplës në drejtime paralele dhe diagonale.	Të dinë mënyrat e mbajtjes së raketës. Të përdorin raketën në raport me topin/puplën në të dyja anët Të dallojnë ndryshimin ndërmjet lojës me top dhe me pupël (ndjeshmëria).	a) E kap dhe e mban mirë raketën, e përdor mirë në të dyja anët. b)Ka përshtatje të mjaftueshme me raketën e puplën. c)Nuk përshtat mirë topin/puplën me raketën.
7.3	Qëndrimet e lojtarëve në fushë	Pozicionet fillestare të qëndrimit të lojtarit në fushë. Vendosja e lojtarëve në lojën me një lojtar. Vendosjet e lojtarëve në lojën me dy lojtarë. Mënyra e zhvendosjes (lëvizjes) së lojtarëve në fushë	Të dinë pozicionin fillestar të qëndrimit. Të dinë të vendosen në fushë në lojën me një lojtar. Të dinë të vendosen në fushë në lojën me dy lojtarë. Të dinë teknikën e lëvizjes (zhvendosjes) në fushë	a)Përcaktojnë me saktësi qëndrimin dhe zhvendosjet në fushë në lojën çift dhe tek. b)Demonstrojnë pozicione të përshtatshme qëndrimi në fushë. c)Demonstrojnë nivel të ulët të përcaktimit të pozicioneve të qëndrimit.

6.7 PINGPONG

Nr.	Nënlinja	Përmbajtja	Objektivat	Arritjet
1	Njohuri	Vlerat shëndetësore dhe shoqërore të lojës. Historik i shkurtër i lojës. Regullore e lojës, elementet e saj të thjeshta nga ana teknike (fusha, rrejta, topi, raketa, seti).	Të pajisen me njohuritë e nevojshme për vlerat e lojës. Të dinë se ku e si ka lindur kjo lojë.	a) Di vlerat e lojës, njeh rregulloret teknike, mund të improvizojë një fushë. b) Di për lojën, por nuk ka njohuri të mjaftueshme për rregulloren e saj c) Ka pak njohuri për vlerat e lojës, njeh tavolinën, rrjetën e topin.
2	Përshtatje me raketën e topin	Zhonglimi i topit me pëllëmbë. Zhonglimi i alternuar i topit me pëllëmbë/shpinë. Zhonglimi i topit më pëllëmbë, i alternuar me vendosje përballë murit (largësia caktohet nga vetë mësuesi) Mënyrat e mbajtjes së raketës. Mbajtja e topit në ekulibër me raketë: - Në vend, - gjatë ecjes drejt, - gjatë ecjes drejt dhe me prekjen e objekteve të ndryshëm, - gjatë ecjes me ndryshim drejtimi.	Të ndihmohet përshtatja me raketën si dhe zotërimi i topit në vend e lëvizje pa tavolinë Të merren njohuri mbi mënyrat e mbajtjes së raketës. Përsosja e bashkëveprimit raketë-top.	a) Zotrojnë me të gjitha mënyrat raketën, e godet topin me pëllëmbë e shpinë duke e zhongluar atë mbi 100 herë. b) Si në a), por e godet topin me pëllëmbë e rrallë me shpinë duke zhongluar 50-60 herë. c) Si në a), por e godet topin me pëllëmbë e rrallë me shpinë duke zhongluar deri më 30 herë.
3	Shërbimi	Qëndrimi fillestar trup-këmbë, duke mbajtur raketën në një dorë e	Të marrin një qëndrim të rregullt fillestar.	a) Njeh rregullat bazë të qëndrimit fillestar dhe e kryen

		<p>topin në dorën tjetër. Mënyrën e shërbimit të topit me përllëmbë. Mënyrën e shërbimit të topit me shpinë.</p>	<p>Të fitojnë shkathtësitë e shprehitë e nevojshme lëvizore për të kryer shërbimin e lehtë në fushën e kundërshtarit në dy zona: majtas e djathatas</p>	<p>shërbimin me pëllëmbë e me shpinë në zona të caktuara. b) E kryen shërbimin me pëllëmbë në zona të caktuara. c) E kryen shërbimin me pëllëmbë jo të paracaktuar.</p>
4	Kalimet e topit	<p>Kalimi i topit diagonal në dy pozicionet (pëllëmbë e shpinë), i lehtë. Kalimi i topit paralel me dy pozicione, i lehtë.</p>	<p>Zhvilimin e cilësive psikomotore me synim automatizimin e veprimeve lëvizore për të kryer sa më shumë kalime pa ndërprerje.</p>	<p>a) Kalon topin në drejtimin diagonal dhe paralel me të dyja pozicionet. b) Kryen kalimin e topit diagonal dhe paralel vetëm me pëllëmbë. c) Kryen kalimin e topit pa përcaktim, vetëm me përllëmbë.</p>
